

Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi

Çrregulluesit në tokë

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2020

Autor:

Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi

Titulli:

Çrregulluesit në tokë

Përktheu:

Dr. Musli Vërbani

Korrekttoi:

Burim Bunjaku

Shtypi:

Focusprint, Shkup

Botues:

Përkthyesi

Kaçanik, 2020

Të drejtën e ribotimit e rezervon përkthyesi

Kapitulli i parë:

DYSHUESIT

Fjalë në të cilën nuk ka dyshim

Zoti i Lartmadhëruar flet me fjalët e shkronjave tona. Fjala e Tij është mrekulli mbinatyrore. Në fjalët e Tij ka gjallëri sepse gjithmonë sjell diçka të re. Kur flet njeriu, ai e flet atë ide apo mendim që i paraqitet në atë moment, mirëpo fjala e Zotit të Lartmadhëruar nuk është kështu, fjala e Tij është mrekulli mbinatyrore. Kjo fjalë, si mrekulli mbinatyrore duhet që të quhet LIBËR. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

الم ﴿١﴾ ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

“ELIF, LAAAM, MIIIM. Ky është LIBRI në të cilin nuk ka fije dyshimi. Udhëzues për të devotshmit.” (El Bekare : 1, 2)

Libri i cili e meriton të quhet LIBËR është Kur’ani fisnik, sepse e ka arritur atributin e të shkruarit dhe në atë përshkruan udhëzimin UDHËZIM, është tregueshmëria e cila të shpie te e mira e kërkuar. Kush është ai i cili e ka vendosur rrugën për te e mira?

Ai është Allahu! E, kush është më i ditur se Allahu?!

Ndonjëherë njerëzit vendosin rrugën e cila të shpie te e mira, mirëpo dituria e tyre është e kufizuar, aftësitë e tyre janë të kufizuara, urtësitë e tyre janë të kufizuara. Për këtë arsye, ata e vendosin rrugën varësisht prej kapacitetit të tyre të kufizuar si në aftësi, dituri, e po ashtu edhe në urtësi.

Kur Zoti i Lartmadhëruar e vendos për njerëzit rrugën për UDHËZIM, Ai e vendos me urtësinë absolute të Tij, me diturinë absolute të Tij dhe me aftësinë absolute të Tij. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Udhëzim për të devotshmit.” kjo u referohet atyre që besojnë, pra:

Besojnë në atë që fshihet prej shikimit të tyre, e kjo fshehje është prej Zotit i Cili është i Fuqishëm, i Cili ka mundësi për çdo send dhe i Cili është Krijues;

Besojnë në:

- melekët;

- në librat dhe në të dërguarit e Tij;

- në ditën e gjykimit.

Të gjitha këto janë çështje sekrete.

Në *çështjet sekrete* hyn edhe çështja e fshehtë e një rëndësie kulminante, e ajo çështje është *besimi në fjalën e Allahut*.

Perceptimi dhe besimi obligativ

Kur Zoti i Lartmadhëruar i përmend melekët, ndërsa ti nuk i sheh ato, atëherë ti thuaj: Po, ekzistojnë ato, edhe pse ti nuk i sheh ato, sepse Ai i cili të ka lajmëruar (treguar) për ato, Atij i ke besuar me logjikë të shëndoshë dhe ke besuar se Ai është Zot.

Përderisa Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Unë i kam krijuar Melekët. Nuk do të thotë se ne nuk i kushtojmë kujdes kësaj fjale të Allahut, për shkak se ne nuk i shohim melekët, sepse kjo do të nënkuptonte që sytë tanë të gjykojnë për Allahun. Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që të gjykojmë për gjithçka, për pjesët tua të trupit, për mendjen tënde. Çështja se ti nuk i kupton melekët, është diçka në vetvete, ndërsa ekzistenca e tyre është diçka tjetër, sepse të ekzistuarit e një çështjeje është diçka, ndërsa të perceptuarit e asaj çështjeje është diçka tjetër.

Ti e ke shpirtin, e cila ndikon që ti të kesh jetë dhe të lëvizësh, mirëpo a mos e ke parë atë!? A e ke dëgjuar atë!? A e ke shijuar?! A e ke prekur me çfarëdo mjeti qoftë? Dhe, me çfarë mjeti të të perceptuarit e ke perceptuar? Pastaj ti e percepton shpirtin tënd, por e ke perceptuar me gjurmët dhe ndikimin e tij me lëvizjen e materies tënde ashtu që nëse ndahet shpirti prej trupi, bëhesh trung dhe kalbesh. Kështu pra, ti e ke kuptuar me gjurmët e saj në ty, ajo është një e krijuar të cilën nuk e sheh, e si mund ta shohësh Krijuesin.

Ti je i paaftë që të shohësh një të krijuar brenda vetes tënde, e cila është në veten tënde, mirëpo prapëseprapë nuk mund ta perceptosh, pos me gjurmët e tij, e pastaj mundohesh dhe thua: Unë nuk e kam parë të vërtetën. Ti dëshiron që ta shohësh Krijuesin, ndërsa ende nuk e ke parë shpirtin tënd, i cili është i krijuar në ty. E si dëshiron ta shohësh Krijuesin?!

Kulminacioni i besimit në besimin e të padukshmes

Nëse besojmë në kulminacionin e fshehtësive, atëherë ne veç kemi besuar në atë çka ka thënë Zoti i Lartmadhëruar, edhe pse nuk i kemi parë. Zoti i Lartmadhëruar sjell shembuj në vet njerëzit. Para se që të zbuloheshin mikrobet, njerëzit mendonin se në vetveten janë paraqitur sëmundje, ndërsa nuk i perceptonin simptomat e atyre sëmundjeve, si p.sh.: ngritjen e temperaturës, e të ngjashme. Nuk e kanë ditur çka është mikrobi. Pasi që medicina është zhvilluar dhe Zoti i Lartmadhëruar u ka dhënë leje mikrobeve që të dalin në sipërfaqe dhe që të shihen, ashtu që të identifikohen dhe të njihen dhe kur Zoti i Lartmadhëruar ka dhënë leje që të zbulohen, atëherë mikrobet, me mikroskop i kemi parë ashtu siç janë.

Në fillim, ne nuk i kemi parë mikrobet, sepse ato nuk është e mundur të shihen me sy të lirë, pra mikroorganizmat nuk i sheh syri. Një send i cili nuk mund të shihet me sy, ai send nuk mund të përfshihet, argument për këtë e kemi se: Kur e sheh një njeri të madh para vetes dhe pastaj ai largohet nga ti dhe shkon në një distancë të largët nga ti, atëherë çdo hap që largohet nga ti zvogëlohet përballë shikimit tënd dhe madhësia e tij shkon dhe i ngjan një fëmije të vogël. Nëse vazhdon të largohet edhe më shumë, atëherë humbet dhe nuk mund ta shohësh fare.

Kështu pra, ku shkoi? Ai veç ekziston, mirëpo me largimin e tij, madhësia e tij është zvogëluar deri në atë masë sa që sytë e tu nuk mund ta shohin. Nëse na e sjellin teleskopin për t'i afruar sendet e largëta e shohim prapë atë njeri. Nëse ti nuk e sheh një send, kjo nuk do të thotë se nuk ekziston, por mjeti shikues në trupin tënd është i paaftë ta shohë atë.

Nëse më herët do t'u tregonim pleqve për mikrobet, a do të na kishin besuar?

Natyrisht se nuk do të na kishin besuar.

Kështu pra, Zoti i Lartmadhëruar, i ka lënë disa sende që të mos shihen për një kohë, të cilat janë nën nivelin e të shikuarit me sy. Pastaj, pas një kohe, ia kemi arritur t'i shohim. Kjo i bie, sikur Allahu të ketë thënë: Mos e moho të padukshmen sepse kjo (mikrobet) në të kaluarën ka qenë e

padukshme, e pastaj ua mundësova që të prodhoni mjete teknologjike që t'i shihni, që të argumentohet se e padukshmja ekziston, por ti nuk e sheh.

Kështu pra, ata të cilët besojnë në të padukshmen, janë në piedestalin më të lartë të besimit, ata besojnë në Zotin, besojnë në Ditën e gjykimit, ata e falin namazin rregullisht, adhurimi ndaj Zotit përsëritet vazhdimisht duke falur namaz pesë herë në ditë.

Domosdoshmëria e besimit për të besuar atë çka ka zbritur prej Zotit

Ne e vërejmë se Zoti i Lartmadhëruar e ka treguar gjysmën tjetër të besimit kur thotë:

وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ

“Ata të cilët besojnë në atë që të ka zbritur ty dhe çka ka zbritur para teje.” (El Bekare : 4)

Pjesa **“dhe çka ka zbritur para teje”** nuk ka ardhur si atribut për besimtarët e mëhershëm (para Muhamedit dhe zbritjes së Kur'anit) sepse islami ka ardhur për t'u drejtuar dy llojeve të njerëzve, e ata janë:

Lloji i parë: Ata të cilët nuk besojnë në Zotin. Këta nuk besojnë as në Zotin dhe as në peygamberët, të cilëve u zbrit shpallja prej Zotit.

Lloji i dytë: Janë pasuesit e librit. Këta besojnë në Zotin, në peygamberët e Zotit dhe në librat e Zotit.

Patjetër se besimi islam paralelisht dëshiron që t'i organizoj të dy llojet. Pse?

Nga shkaku se, ani pse pasuesit e librit janë në lidhmëni me Zotin dhe besojnë në Të, në librat e Tij dhe peygamberët e tij, por a u mjafton kjo?

Ne themi jo! Besimi islam ka ardhur që të ballafaqohet me të dy taborët, ashtu që e tërë feja të jetë prej Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të sqaroj se besimi ka ardhur që të jetë i përshtatshëm për të gjithë, ka dashur të sqaroj se besimi për diçka dhe të përmbajturit të planprogramit të Atij të cilit i beson, sjell të mira dhe begati dhe e largon të keqen nga ti. Përderisa besimi e kërkon këtë nga ti, kjo do të thotë se ekzistenca e së keqes e lufton besimin.

Po të mos kishte qenë e keqja, nuk do të kishte qenë domosdoshmëria e besimit.

Mënyra e besimit në Ditën e fundit (ditën e gjykimit)

Domosdoshmëria e njeriut për të besuar është që ai të arrij ta mbrojë dhe ta siguroj veten e tij dhe që ta mbroj dhe ta siguroj jetën e tij nga të këqijat, nga kjo rrjedh se e kundërta e besimit është pabesimi. Kështu pra, është çështje normale që pabesimtarët të jenë kategori e kundërt me besimtarët:

وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ

“Ata të cilët besojnë në atë çka të ka zbritur ty dhe që ka zbritur para jush dhe për Ditën e gjykimi janë të bindur.” (El Bekare : 4)

Nëse e shfleton Tevratin, i cili ka qenë libër i jehudëve të cilët kanë jetuar në Medinë në epokën e islamit, ata kanë pasur urrejtje ndaj islamit për shkak të kryelartësisë, edhe pse vet ata polemizonin me pabesimtarët. Ndërsa kur u ka ardhur Kur’ani nuk e kanë pranuar, por e kanë mohuar. Ti, nëse e lexon Tevratin apo Talmudin, nuk mund të gjesh diçka për Ditën e gjykimit, sepse ata në librat e tyre janë interesuar për çështjet materialiste.

Zoti i Lartmadhëruar e ka përfunduar me besimin në Ditën e gjykimit, sepse ata të cilët kanë thënë se:

- ne besojmë në Zotin,
- ne besojmë në librat dhe
- ne besojmë në peygamberët e Tij, nuk e kanë e kanë hetuar besimin në Ditën e fundit (gjykimit) dhe po të mos kishte zbritur pjesa e ajetit për të besuar në Ditën e fundit (gjykimit), ndoshta nuk do ta kishin pasur këtë qëndrim edhe në të ardhmen.

Islami dëshiron ta pasqyroj besimin të kompletuar fillim e mbarim, ashtu që besimi në Zotin të jetë fillimi i besimit, ndërsa besimi në Ditën e fundit (të gjykimit) të jetë përfundimi i pasqyrimit të besimit.

Islami dëshiron të jetë i kompletuar, ashtu që të të organizoj në formën e besimit në pikën e startimit dhe të fillimit deri te besimi në Ditën e fundit dhe të Gjykimit në pikën e përfundimit.

Llojet e besimit

Besimi është dy kategorish:

Kategoria e parë:

الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ

“Ata të cilët besojnë në të padukshmen dhe e falin namazin.” (El Bekare : 3)

Kategoria e dytë:

وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ ﴿٤﴾

“Ata të cilët besojnë në atë që të ka zbritur ty dhe çka ka zbritur para jush dhe në Ditën e Gjykimit janë të bindur.” (El Bekare : 4)

Zoti i Lartmadhëruar dëshiron:

- në rend të parë t’i “**cilësoj ata të cilët kanë besuar**”;

- në rend të dytë t’i tregoj “**ata të cilët kanë besuar**”.

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar thotë:

أُولَئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ ۖ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٥﴾

“Ata janë të cilët janë të udhëzuar prej Zotit të tyre dhe ata janë të cilët janë të shpëtuar.” (El-Bekare : 5)

Fjala “**ata**” për kë thuhet?

Fjala “**ata**” thuhet për të dy kategoritë, që do të thotë për të dy kategoritë e besimit. Kjo është e saktë.

Të shohim se ku bashkohen këto dy kategori dhe a janë të njëjta cilësitë te “**ata të cilët janë të udhëzuar**” dhe te “**ata të cilët janë të shpëtuar**”. Shohim se kallëzuesi i tyre ndryshon:

Në pjesën e ajetit “**ata të cilët janë të udhëzuar**” shohim se “**udhëzimi**” është tregueshmëria e cila të shpie te e kërkuara.

Përderisa **“ata të cilët” janë të shpëtuar**” shohim se e kërkuara është përfundimi i çështjes, që do thotë **“ata janë në udhëzim dhe për këtë arsye kanë shpëtuar”**.

Kështu pra:

Kuptimi i të parës është: tregueshmëria për të arritur te e kërkuara.

Kuptimi i të dytës është: përfundimi është shpëtimi.

Në këtë rast pyesim:

Të parët, a e kanë vetëm tregueshmërinë dhe nuk e kanë përfundimin?
Dhe

të dytët a e kanë përfundimin dhe nuk e kanë tregueshmërinë?

Apo që të dy kategoritë e kanë tregueshmërinë për udhëzim dhe që të dy kategoritë e kanë përfundimin për të shpëtuar.

Natyrisht se përgjigja është se, që të dy kategoritë kanë tregueshmërinë për udhëzim dhe që të dy kategoritë përfundimin e kanë në shpëtimin e tyre.

Kështu pra, përfundojmë te thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

أُولَئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ ۖ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Ata janë të cilët janë të udhëzuar nga Zoti i tyre dhe ata janë të cilët janë të shpëtuar.” (El Bekare : 5)

Kur tërhiqet vërejtja patjetër se duhet përqendrim

Prej retorikës së Kur'anit është se një kategori e sinjalizon me diçka, ndërsa kategorinë tjetër e sinjalizon me diçka tjetër, dhe po ashtu prej sintaksës së Kur'anit është se, kur i ngërthen dy çështje, secila prej tyre ka dy ligje. Kështu shohim se: Ka përshkruar çështjen me ligjin e parë, përderisa të lë në dispozicion që ta nxjerrësh çështjen e kundërt të saj në ligjin e dytë:

قَدْ كَانَ لَكُمْ آيَةٌ فِي فُتُتَيْنِ التَّفَّاتِ

“Dhe veç keni shenjën për ju (me rastin) e dy grupeve kur u takuan.” (Ali Imran : 13)

Dhe kështu kur janë takuar pabesimtarët me besimtarët në betejë. Ne e dimë se janë takuar dy grupe për dy çështje:

E para: grupi i besimtarëve i cili lufton në rrugë të Allahut.

E dyta: grupi i pabesimtarëve, i cili lufton në rrugë të shejtanit.

Nëse e analizojmë më thellë ajetin, nga kjo mund ta paramendojmë këtë kuptim: për ju ka qenë një shenjë për të dy grupet. Grupi i besimtarëve të cilët luftojnë në rrugë të Allahut dhe grupi i pabesimtarëve të cilët luftojnë në rrugën e shejtanit. Zoti i Lartmadhëruar nuk ka dashur që ta përsërit këtë, por vetëm duke e lënë në mendjet tuaja, që të hapen mendjet tuaja, atëherë kur të kuptohet fjala e Allahut, ashtu që të kuptohen begatitë e Allahut.

Me këtë, Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që të tërhiqet vëmendja në të kuptuarit e Kur'anit dhe nuk ka thënë:

“Dhe veç keni shenjën për ju (me rastin) e dy grupeve të cilët janë takuar në rrugën e Allahut.”, por e ka anuluar në mënyrë retorike fjalën besimtar prej grupit të parë dhe ka thënë: **“Lufton në rrugë të Allahut”** ashtu që ty të të shkoj mendja se ai grup është besimtar, përderisa lufton në rrugë të Allahut.”

Ndërsa në grupin tjetër, e ka anuluar retorikisht të kundërtën e **“në rrugë të Allahut”** e që do të ishte **“në rrugë të shejtanit”** dhe e ka përdorë përballë të kundërtës, pra **“pabesimtarë”** ashtu që i bie sikur:

e kundërta e **“besimtarit”** është **“pabesimtari”** dhe

e kundërta e **“në rrugë të Allahut”** është **“në rrugë të shejtanit”**.

Kështu pra, e ka anuluar retorikisht **“besimtarin”** në grupin e parë që të kuptohet prej fjalës **“pabesimtarë”** pra të grupit të dytë, dhe në të njëjtën mënyrë e ka anuluar me anë të retorikës **“në rrugë të shejtanit”** e që në sintaksë quhet **“përputhshmëri”** dhe kjo nga shkak që të na mësoj se si t’i qasemi Kur’anit.

Kur ta dëgjojmë se si Zoti i Lartmadhëruar e mëson të dërguarin e Allahut kur thotë:

“Thuaj: Po nëse unë shpifi për të, atëherë mua më takon përgjegjësia e krimit, ndërsa unë nuk jap përgjegjësi për atë që kriminalizoni ju.”

Atëherë, përderisa është **“shpifja”**, si mundet me ndodh kriminaliteti i tyre, sepse ata nuk kanë bërë kriminalitet. Kështu që i bie se, çështja është e dy çështjeve:

- Ose unë kam shpif;
- Ose unë nuk kam shpif.

Nëse unë kam shpif, atëherë kam bërë kriminalitet dhe ju nuk mbani përgjegjësi dhe nuk jeni fajtorë, por,

nëse unë nuk kam shpif, atëherë ju jeni ata që keni bërë krim.

Pra, edhe këtu është përputhshmëria.

Kemi shumë e shumë raste ku ekziston **“anulimi retorik”** ashtu që të përqendrohet vëmendja. Kemi edhe rastin e ajetit fisnik:

اَذْهَبْ بِكِتَابِي هَذَا فَأَلْقَهُ إِلَيْهِمْ ثُمَّ تَوَلَّ عَنْهُمْ فَانْظُرْ مَاذَا يَرْجِعُونَ

“Shko me këtë letrën time dhe dorëzoje te ta dhe pastaj kthehu prej tyre dhe vështro çka do të veprojnë (si do ta kthejnë përgjigjen).” (En Neml : 28)

Dhe menjëherë rezulton ajeti tjetër:

قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ إِنِّي أُلْقِيَ إِلَيَّ كِتَابٌ كَرِيمٌ

“Tha: O ju pari, vërtet mua më është dërguar një letër fisnike.”
(En Neml : 29)

Kjo nga shkak se nuk është e patjetërsueshme përgjigja, sepse vet logjika e shëndoshë e kupton ngjarjen e mëtutjeshme dhe rezultatin përfundimtar:

الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ

“Ata të cilët besojnë në të padukshmen dhe e falin namazin dhe me çka janë furnizuar ata, shpërndajnë.” (El Bekare : 3)

Pastaj...

أُولَئِكَ عَلَى هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Ata janë të cilët janë në (mbi) rrugë të drejtë të Zotit të tyre dhe ata janë të cilët janë të shpëtuar.” (El Bekare : 5)

Ne e shohim se Zoti i Lartmadhëruar i ka bashkëngjitur dhe i ka ndërlidhur të dy grupet së bashku, sepse pas islamit nuk ka dy besime, por vetëm një besim për të cilin është vetëm një shpërblim dhe mjeti i saj është **“rruga e drejtë”** dhe përfundimi i saj është **“shpëtimi”**.

Domosdoshmëria e të përmbajturit e rrugës së drejtë

Nëse i analizojmë obligimet të cilat tregojnë rrugën e cila të shpie te e kërkuara, vërejmë se Zoti i Lartmadhëruar e ngrit të udhëzuarin nga udhëzimi, që do të thotë se udhëzimi nuk është vendosur për ty me qëllim që të të poshtëroj, por përkundrazi është vendosur për të të ngritur. Është e qartë se udhëzimi është vendosur që të transportohesh ti me qenien tënde. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe Ne, ose ju, jeni ose mbi rrugën e drejtë ose ju nën humbjen e sigurt.”

Shiko **“mbi rrugën e drejtë”**, fjala është për zhvillim dhe ngritje. Kjo i bie sikurse të thuhej: Ti je mbi kalin fisnik, ose mbi kafshën ose mbi kulm. Kjo tregon për ngritje dhe zhvillim, ashtu sikurse i udhëzuari kur i përmbahet udhëzimeve për të arritur tek e dëshiruara, ai nuk nënçmohet me atë udhëzim, por ngrihet mbi rrugën e drejtë. Rrugë e drejtë - i dorëzohet urdhrave të tij, kështu që e sjell tek e mira dhe e dobishmja, mirëpo rruga e humbur të mbyll dhe të burgos në veten e saj. Për këtë arsye analizo të kundërtat: **“mbi rrugën e drejtë”** ose **“nën humbjen e sigurt”**.

“Lartësia” dhe **“ngritja”** është përmendur për udhëzimin, edhe pse t’i përkufizon lëvizjet, ajo me atë përkufizim të ngrit lartë ty, në një shkallë të lartë, në një pozitë të lartë, ose në një respekt të lartë, sepse ti nuk merr ligje nga njeriu, por nga vetvetja gjykon, ashtu që udhëzimi të ngrit ty që të udhëzohesh prej Allahut.

Besimi ndahet në dy kategori:

Kategoria e parë:

“Ata të cilët besojnë në të padukshmen dhe e falin namazin.”

Kategoria e dytë:

“Ata të cilët besojnë në atë çka të ka zbritur ty, dhe në atë çka ka zbritur para teje, dhe janë të bindur në Ditën e fundit dhe të gjykimit.”

Zoti i Lartmadhëruar në rend të parë dëshiron t'i cilësoj **“ata të cilët kanë besuar”**.

Pastaj në rend të dytë prapë **“prapë ata të cilët kanë besuar”**.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

أُولَئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ ۚ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Ata janë në udhëzimin e Zotit të tyre dhe ata janë të cilët do të jenë të shpëtuar.” (El-Bekare : 5)

Dhe **“ata të cilët”** kallëzues i cilës kryefjalë janë?

Pra, është kallëzues i të dy kategorive, pra të kategorisë së parë dhe të dytë.

Kjo është e vërtetë.

Ta hulumtojmë tani unifikimin e të dy kategorive. A janë të njëjtë që të dy kategoritë, pra, pjesa e ajetit **“ata të cilët janë në rrugë të drejtë”** dhe **“ata janë të cilët do të jenë të shpëtuar”**.

Ne e vërejmë se kallëzuesi ndryshon.

Në pjesën e ajetit **“ata të cilët janë në rrugë të drejtë”**, shohim se **“rruga e drejtë”** është tregues i cili të shpie te e kërkuara, përderisa,

te pjesa e ajetit **“ata janë të shpëtuar”**, shohim se e kërkuara është te *qëllimi përfundimtar*. Që do të thotë se, ata të cilët janë në rrugën e drejtë arrijnë deri te suksesi i shpëtimit.

Kështu pra...

Kuptimi i parë është: Udhëzimi i cili të shpie te e kërkuara.

Kuptimi i dytë është: Qëllimi përfundimtar, e ai qëllim është *shpëtimi*.

Në këtë rast parashtrohet pyetja:

Të parët e kanë vetëm rrugën e drejtë dhe nuk e kanë për qëllim pikën kulminante, ndërsa të dytët e kanë për qëllim pikën kulminante dhe ata nuk janë të udhëzuar, apo që të dytë, së bashku është fitimi?

Natyrisht se, që të dy kategoritë janë të udhëzuar dhe në rrugë të drejtë dhe që të dy kategoritë kanë për qëllim fitimin (shpëtimin).

Pas kësaj, ndalemi te thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

أُولَئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ ۚ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Ata janë në rrugë të drejtë nga Zoti i tyre dhe ata janë të shpëtuar.” (El-Bekare : 5)

Kapitulli i dytë:

Hipokritët

Zemra e shëndoshë

1. Zemrat e shëndosha dhe të devotshme në krahasim me të tjerat.

Shoqëritë ndahen në tri lloje:

Lloji i parë: Shoqëria në të cilën individët i bëjnë dëm vetes së tyre, prej nefsit i cili urdhëron në të keqe, ashtu që ai nefs e thërret në mëkat, por në këtë shoqëri ekziston edhe nefs i bindur dhe qortues, që i ndihmon ta përmbajë veten dhe të mos bie në grackën e nefsit i cili i urdhëron në të keqe. Kështu që njeriu gjendet në dy gjendje e ato janë:

- urdhërues,
- qortues.

Shoqëria në të cilën është nefs i bindur dhe i kënaqur, në atë shoqëri mbizotëron e mira, në atë shoqëri ka njerëz të cilët nuk janë qortues, vetëm se te ata i shikojnë individët tjerë të cilët e kanë nefs qortues, që t'i qortojnë të tjerët për veprimet jo të mira.

Kështu pra, në këtë lloj kemi qortim të një nefs te nefs tjetër, për ta zgjuar nefs qortues tek individët të cilët e kanë nefs urdhërues për keq, kështu që vendoset drejtësia, që do të thotë se nefs ballafaqohet me një nefs tjetër, pa pasur nevojë që të ndërhyjë ndonjë shoqëri tjetër.

Lloji i dytë: në shoqëri ekzistojnë gjithmonë nefset të cilat urdhërojnë për të keqe dhe në ta nuk ka nefse qortuese, pastaj në atë shoqëri shkon një shoqëri e mirë që Allahu nëpërmjet tyre ta dominoj të mirën dhe kështu ata i drejtojnë njerëzit për të mirë.

Lloji i tretë: është shoqëria katastrofale, ashtu që e keqja e kaplon çdo individ të shoqërisë dhe në atë shoqëri ka vetëm nefse të cilat urdhërojnë për keq dhe nuk ka asnjë nefs qortues, nëse vjen kjo, atëherë intervenon programi qiellor sepse njerëzit nuk kanë qenë në gjendje të i drejtojnë shtrembërimet e njerëzve.

Qielli intervenon atëherë kur e keqja arrin në maksimum dhe atëherë kur e keqja arrin në shkallën më të lartë, atëherë vjen e drejta dhe mos mendoni se e keqja i dorëzohet të drejtës, ajo prapë mbetet në egërsinë e vet. Në këtë periudhë e drejta ballafaqohet ose me armiq të hapur ose me armiq të fshehtë.

Fuqia e hipokrizisë

Shpirti njerëzor dëshiron të jetë i fuqishëm, mirëpo dashuria për forcën në vetvete ndryshon:

1. Një pjesë mendon se shpirti forcohet vetvetiu.
2. Një pjesë tjetër mendon se para se të forcohet vetvetiu duhet që ai vet ta forcojë veten e tij.
3. Kemi shpirta tjerë të cilat nuk forcohen as nga vetvetja e as nga të tjerët.

Sa i përket njeriut besimtar, ai është i fuqishëm nga vetvetja sepse i përmbahet planprogramit të Allahut të Lartmadhëruar dhe është i fuqishëm për t'u ballafaquar me stuhitë e së keqes. Brenda vetes së tij ka forcë kundër nefsit urdhërues për të keqe, ai ka forcë kundër stuhive të së keqes dhe kështu te besimtari bashkohen dy forca, mirëpo te pabesimtari ekziston vetëm një forcë, ai nuk e ka përgatitur veten që ta zbatojë planprogramin e Allahut dhe nuk është përgatitur që të ballafaqohet ndaj ftesës së të keqes.

Ekziston edhe një lloj tjetër. Nuk e forcon veten e tij dhe nuk ka forcë që ta sulmojë ftesën e së mirës.

Kështu pra, kjo kategori është e izoluar nga të dy forcat, e këta janë hipokritët.

Hipokriti nuk e ka forcuar veten e tij, për këtë arsye ai nuk mund ta pranojë ftesën e të së vërtetës sepse nefs i tij është i keq, të cilin e ka përgatitur e keqja në mënyrë perfide, sikur hipokriti të ishte i fuqishëm për ta sulmuar ftesën e së mirës me fuqinë e tij, por jo, ai nuk e ka atë fuqi, por frikohet prej së mirës dhe haptas e thotë besimin për të mirën sepse ai nuk ka forcë për t'u ballafaquar me të mirën, po ashtu, nuk ka forcë të ballafaqohet edhe me veten e tij, dhe nuk ka aftësi të ballafaqohet dhe të jetë i sigurt nga e vërteta. Hipokritët janë më të këqijtë e të dy kategorive.

Hipokritët janë më të këqij se pabesimtarët. Pabesimtari kokëfortë, haptazi dhe qartë me forcën e tij të fshehtë e paraqet në mënyrë arrogante dhe nuk e fsheh, mirëpo hipokriti e fsheh forcën e tij të fshehtë me të cilën thërret. Ah sikur ta thërriste veten me atë dukuri, por ai është i padrejtë në të. Kjo është sikurse e sulmon të vërtetën në dy drejtime.

- drejtimi i parë, armën pozitive, ashtu që të vërtetën e llogaritë si armë me të cilën lufton.

- drejtimi i dytë, armën negative, kur ai nuk pajtohet me besimin e atij me të cilin e ka armën për të qëndruar në rrugën e vërtetë.

Shembull i kësaj, kur ai paraqitet me ty para armikut dhe e ka armën në dorë, e edhe ti e ke armën, pastaj ti ia merr armën atij.

Nuk thuhet, është një armë mangë, por thuhet mungojnë dy armët, sepse ti i ke dy armë dhe ai nuk ka armë. Kështu pra, fuqia e hipokrizisë dhe agresiviteti i tij është se ai vepron për të të dërguar në errësirë, ndërsa tjetrit ta ndriçon, e kjo është më e vështirë për islamin në ballafaqim me pabesimin. Për këtë arsye, ne shohim se Zoti i Lartmadhëruar tre ajete ia ka kushtuar besimtarëve, dy ajete pabesimtarëve, ndërsa çështjes së hipokritëve ia ka kushtuar trembëdhjetë ajete sepse hipokrazia paraqitet në forma të shumënumërta dhe të shumëllojshme.

Esenca e hipokrizisë është e llojllojshme, as nuk është e fuqishme për të dalë në ballë dhe për ta kundërshtuar të vërtetën, dhe as nuk është ndonjë forcë e cila pajtohet dhe e beson të vërtetën, për këtë arsye çështja e saj merr dy drejtime.

Fushëbeteja e besimit

Zoti i Lartmadhëruar na ka mësuar që, kur besimtari të beson në Zotin e tij, duhet të qëndron në fushëbetejën e besimit, jo vetëm të qëndron i vetmuar, por që të qëndron në fushëbetejën e besimit kundrejt pabesimit, në fushëbetejën e së vërtetës kundër të pavërtetës sepse ai e ka mbështetjen nga Zoti i Plotfuqishëm, përderisa besimtari vepron me planprogramin e Allahut nuk mund ta mposhtë askush asnjëherë.

Nëse besimtari largohet nga planprogrami i Allahut, ai do të jetë i dështuar, atëherë fuqia është në mes të njeriut dhe njeriut. Për këtë arsye, jeta e të dërguarit s.a.v.s. ka qenë bazë e thirrjes islame, që do të thotë se, çdo sekuençë e cila do të ndodhë deri në Ditën e kiametit ka ndodhur në biografinë (jetën) e të dërguarit të Allahut s.a.v.s. Zoti i Lartmadhëruar ka dëshiruar që t'i mësoj muslimanët me praktikën e Muhamed bin Abdullahut dhe me jetën e tij.

Shembull, në luftën e Uhudit, muslimanët kanë pësuar disfatë. Në aspekt të jashtëm të gjithë muslimanët kanë pësuar disfatë, por në realitet, ata të cilët kanë pësuar disfatë janë muslimanët të cilët nuk kanë vepruar me planprogramin Islam. Islami nuk ka fituar nga shkak se, disfata ka ardhur si rezultat i kundërshtimit të urdhrave të të dërguarit të Allahut. Si do të ishte gjendja po që se ata do të fitonin edhe duke e kundërshtuar të dërguarin e Allahut?

Zoti i Lartmadhëruar thotë (komentim):

Keni kundërshtuar, për këtë arsye keni humbur.

Keni kundërshtuar, për këtë arsye keni dështuar.

Kësisoj, orientimi i shpirtrave të besimtarëve mbetet në drejtim të të dërguarit të Allahut.

Qeverisësit e tokës

Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë:

- çështje të Kur'anit të cilat lexohen;
- çështje të Kur'anit të cilat shkruhen;
- çështje të Kur'anit të cilat përsëriten në adhurim dhe namaz. U lexohen njerëzve dhe mësohen përmendësh për Allah.

Allahu, këto çështje nuk i ka lënë që të jenë absolute. Në realitet, në kozmos, këto çështje mund të bien ndesh me njëra-tjetrën. Kur Zoti i Lartmadhëruar e parashih një çështje prej çështjeve, pastaj vjen momenti që të bëhet realitet dhe bien ndesh ato çështje, atëherë në shpirtrat e besimtarëve do të ndodhte çështje poshtëruese. Për këtë arsye, kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَإِنَّ جُنَدَنَا لَهُمُ الْغَالِبُونَ

“Dhe padyshim se ushtria jonë triumfon ndaj tyre.” (Saffat : 173)

...e, shohim se çështja e Kur'anit patjetër duhet të ndodhë sipas ligjeve të natyrës, ashtu që të përputhet me çështjen e Kur'anit. Përderisa këtë e ka thënë Zoti i Lartmadhëruar, atëherë shiko mirë në betejë se cila është ushtria islame, e cilët janë armiqtë e tyre:

- Nëse triumfojnë muslimanët, dije se ata kanë qenë *ushtri e Allahut*.
- Nëse pësojnë disfatë, atëherë dije se fjala e Allahut është e vërtetë: **“Dhe padyshim se ushtria jonë triumfon ndaj tyre.”** (Saffat : 173).

Kjo nga shkaku se kur ata (muslimanët) janë zhveshur (nga islami) janë shpërbërë nga rreshtimi i *rreshtimit të ushtrisë së Allahut*, për këtë kanë pësuar disfatë.

Çështja është e qartë sepse besimtari kur të ballafaqohet me të keqen e së padrejtës, ai duhet ta ketë parasysh se ai nuk ballafaqohet i vetëm, por vepron dhe mbështetet në Allahun. Mbështetja në Allahun nënkupton se ai vepron një vepër dhe mbështetet, për këtë arsye, për ata të cilët qeverisin në tokë, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّا مَكِّنَّا لَهُ فِي الْأَرْضِ وَآتَيْنَاهُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ سَبَبًا

“Ne e kemi bërë që të jetë qeverisës në tokë dhe për çdo çështje i kemi dhënë shkaqe.” (El-Kehf : 84)

A mos Zoti i Lartmadhëruar e ka përkufizuar çështjen jashtë shkaqeve?
Jo! Përkundrazi, në ajetin në vazhdim thotë:

“Dhe ai i pasoi shkaqet.”

Përpos kësaj, shikoje situatën kur islami ishte në Medine dhe se si ishte aty çështja e hipokrizisë.

Hipokrizia është dukuri shpirtërore

Në islam, dukuria e hipokrizisë është dukuri e besimit. Kjo nga shkakut se në islam, në periudhën e Mekës nuk ka pasur hipokrit sepse hipokriti paraqitet përballë të fortit, ndërsa në Meke islami ka qenë i dobët. Muslimanët e parë nuk kanë pasur mundësi ta mbrojnë veten e tyre, e pse të bëhet hipokriti ndaj tyre?

Kur shkoi islami në Medine? Atje ka qenë e patjetërsueshme paraqitja e hipokrizisë. Posaçërisht prej popullit i cili e ka pasur udhëheqjen në Medine. Këtë udhëheqje e ka lëkundur migrimi i Muhamedit s.a.v.s., pasi që deri në atë kohë qeveriste Ibni Seluli dhe këtë çështje në tërësi e përmbysi pejgamberi i ri, migruesi, Muhamedi a.s.

Kjo ka ndikuar në shpirtrat të cilët e prisnin qeverisjen e re dhe në shpirtrat e atyre të cilët organizoheshin për kontrollin e vendit, ashtu që të kontrollonin nominimet e kandidatëve për udhëheqjen e Medines.

Unë mendoj se kjo ka qenë arsyeja e parë e urrejtjes në kohën kur i dërguari ka hyrë në Medine, dhe kjo urrejtje ka buruar nga ky njeri, i quajtur Ibn Selul dhe nga pasuesit e tij.

Gjithashtu, shkuarja e të dërguarit të Allahut në Medine, kërcënonte forcën tjetër e cila i udhëhiqte me dituri, e ata ishin pasues të librit. Ata tregoheshin para tyre (arabëve të Medines) si të ditur, vizionarë dhe të zhvilluar. Ata gjithashtu e mbizotëronin edhe ekonominë sepse ata ishin të pasur. Ata ishin ndezësit e armiqësisë në mes të Evsit dhe Hazrexhit dhe përfitonin prej kësaj armiqësie.

Kur erdh feja islame, ata të cilët ishin të ngatërruar, pra Evsi dhe Hazrexhi, u cilësuan me titullin Ensarë dhe u vëllazëruan me muhaxhirët, atëherë dështoi plani i Jehudëve.

Gjeneruesit e hipokritëve

Feja islame u ballafaqua me dy grupe të fuqishme, e ato ishin: Grupi i hipokritëve dhe grupi i jehudëve.

Kur’ani, kur e parashtron mënyrën e shërimit të hipokrizisë, asnjëherë nuk e lë (pa e përmendur) çështjen e hipokritëve, se kush e gjeneron hipokrizinë në zemra të hipokritëve. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar për ta thotë:

وَإِذَا خَلَوْا إِلَىٰ شَيَاطِينِهِمْ

“Dhe kur të shkojnë te shejtanët e tyre.” (El-Bekare : 14)

që do të thotë se hipokritët shkojnë te shejtanët e tyre. Fjala “shejtan” tregon për armikun e fshehtë të cilin nuk e sheh syri, por e dëshiron të keqen dhe shkatërrimet. Në fjalën “shejtanët e tyre” fshihen jehudët. Fshihen nga shkak se ata do t’i gjenerojnë hipokritët, ata do t’i përdorin ata, ata janë të cilët do të sjellin materialin (drurët) për të ndezur zjarrin e hipokrizisë kundër islamit.

Kur Zoti i Lartmadhëruar e parashtron çështjen e hipokrizisë, e paraqet në mënyrë praktike se si hipokritët kanë dashur ta mbrojnë veten e tyre nga forca e islamit, sepse ata nuk dëshirojnë të ballafaqohen me pabesimtarët. Çka të veprojnë?

E publikojnë fjalën islame me gjuhën e tyre.

Ai i cili e proklamoi fjalën e islamit, atëherë ai i fiton të gjitha të drejtat e Islamit.

Ata i fitojnë të gjitha të drejtat e muslimanëve edhe pse kuptohet se ata janë hipokritë. Pra, respektimi i asaj që proklamohet me islam edhe pse me zemër nuk është i sigurtë. Edhe pse ai i cili e dëshmon me fjalë, patjetër duhet ta zbatojë me vepër. Për këtë arsye, nëse e lexon Kur’anin, lexojmë fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

إِذَا جَاءَكَ الْمُتَافِقُونَ قَالُوا نَشْهَدُ إِنَّكَ لَرَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَاللَّهُ يَعْلَمُ إِنَّكَ لَرَسُولُهُ

“Kur të vijnë tek ti hipokritët, thonë: - Dëshmojmë se ti je i dërguar i Allahut. Por Allahu e di se me të vërtetë ti je i dërguari i Tij.” (El-Munafikun : 1)

A ka dyshim në këtë?

Ata kanë thënë “**Ti je i dërguar i Allahut**”. Ky është realiteti i tyre. Por pas kësaj Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَاللَّهُ يَشْهَدُ إِنَّ الْمُنَافِقِينَ لَكَاذِبُونَ

“Allahu dëshmon se hipokritët janë duke gënjer.”

Në fillim Allahu e ka treguar atë çka kanë thënë, pra e ka treguar fjalën e cila dihet për Allahun, por pas kësaj, i ka gjykuar si gënjeshtarë. Por në çka janë gënjeshtarë?

Munafikët nuk kanë gënjer kur kanë thënë se *Muhamedi është i dërguar i Allahut*. Kjo fjalë është fjalë e vërtetë, pra se *Muhamedi është i dërguar i Allahut*. Por ata kanë gënjer kur kanë thënë *dëshmojmë* sepse dëshmia është fjalë që duhet të përputhet me atë çka është në zemër.

Kështu pra, çështja e dëshmisë është tek Allahu, e ajo është se Muhamedi është i dërguar i Allahut, mirëpo fjala e *dëshmisë* është mjet i gënjeshtres, që asnjë të mos bie në metodologjitë e tyre të rrezikshme. Thonë se ka kundërshtim në mes termave të të njëjtit ajet!!

Ne u përgjigjemi: Sikurse Allahu dëshmon për gënjeshtren, ndërsa në të dytën “e di” do t’i bie se dëshmia prej Allahut është kundërpërgjigje ndaj dëshmisë së të parëve. Kështu pra, ka dallim në mes fjalës dhe thanësit të fjalës.

Dëshmia është çështje më vete, ndërsa,

Thënia e tyre se *ti je i dërguar i Allahut* është çështje tjetër.

Përpos kësaj: Kush është ai i cili i jep përparësi dëshmisë së tyre ndaj dëshmisë së Allahut?

Zoti i Lartmadhëruar e paraqet çështjen ashtu që: Feja islame e respekton proklamimin e tyre se ***Vetëm Allahu është Një dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut*** edhe pse e di se ata vetëm tallen me të.

Koka (kryesori) e hipokrizisë dhe toleranca e të dërguarit të Allahut

Besoj se të gjithë e lexoni ngjarjen e Abdullah Ibn Selulit kur e sheh Ebu Bekrin dhe Umer Ibnul Hatabin. Ibn Seluli u thotë vëllezërve të vet hipokrit: Shikoni si janë bërë bashkë këta mendjelehtët.

Abdullah ibn Seluli ka qenë në kundërshtim me fjalët dhe veprimet e tij sepse ka shkuar te Ebu Bekri dhe i ka thënë: Mirë se erdhe zotëria i Temimit! Mirë se erdhe o sidikë! Mirë se erdhe o shejh i islamit! Mirë se erdhe shoku i Muhamedit në shpellë! Mirë se erdhe, o ti i cili e ke shpenzuar veten dhe pasurinë për Muhamedin!

Pastaj Ibnu Seluli u takua me Umerin dhe i tha: Mirë se erdhe o zotëria i beni Adijut! Mirë se erdhe o Faruk! Mirë se erdhe, o ti i cili e ke shpenzuar pasurinë dhe veten për të dërguarin e Allahut!

Pastaj e takon Aliun dhe i thotë: Mirë se erdhe o dhëndër i të dërguarit të Allahut! Mirë se erdhe o zotëria i beni hashimitëve pas të dërguarit të Allahut!

Shihet se nuk ka fjalë më të mira se këto fjali.

Paramendoni se çka u ka thënë Ibni Seluli popullit të tij më herët. Shikoni me vëmendje, u takua me mendjelehtët, ashtu siç i ka cilësuar. A kanë qenë ata mendjelehtë. I ka cilësuar: zotëria i Temimit, zotëria i beni Adijut. Shikoni se si ibni Seluli është shprehur më herët dhe shikoni se si është shprehur më vonë.

Atyre hipokritëve të cilët kanë vepruar ashtu, është dashtë t'u thuhet: Këto janë vetëm shtrembërime, mirëpo përkundër asaj se i dërguari i Allahut i ka kuptuar, shikojeni tolerancën islame dhe tolerancën e të dërguarit të Allahut, saqë kur ka vdekur Ibni Seluli shkon pejgamberi s.a.v.s. dhe ia falë namazin e xhenazes.

Umeri merr qëndrim tjetër dhe i thotë: - O i dërguar i Allahut, po ia falë namazin kokës së hipokritëve?!

Umeri reflekton, mirëpo i dërguari i Allahut insiston në faljen e namazit dhe thotë: - Zoti i Lartmadhëruar ma ka lënë të drejtën të zgjedh, të lutem për të, por edhe të mos lutem për të. Për Zotin, sikur ta dija se nëse më duhet të lutem për të më shumë se shtatëdhjetë herë që të më pranohet lutja, do të isha lutur.

Zoti i Lartmadhëruar e ka respektuar mendimin e Umerit dhe e ka zbritur ajetin, ku në një rën anë e ka arsyetuar mëshirën e të dërguarit të Allahut për ata, por Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

وَلَا تُصَلِّ عَلَى أَحَدٍ مِّنْهُمْ مَاتَ أَبَدًا وَلَا تَقُمْ عَلَى قَبْرِهِ ^ع إِنَّهُمْ كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَمَاتُوا وَهُمْ فَاسِقُونَ

“Dhe mos ua falë namazin asnjërit prej tyre dhe mos qëndro dhe të lutesh te varri i tyre. Vërtet ata mohuan Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe vdiqën deri sa ata ishin mëkatarë.” (Et-Tevbe : 84)

Kur të ndalohej i dërguari i Allahut, ai ndalim ka qëllim të çështjes tjetër, ndërsa nëse mbetet çështja në kompetencën e të dërguarit të Allahut, atëherë i dërguari i Allahut vepron atë çka e kërkon që ai të jetë *mëshirë për të gjithë botën*.

Hipokritët dhe feja islame

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“Ne të kemi dërguar mëshirë për gjithë botët.” (El-Enbija : 107)

Ky është një peizazh i cili pasqyron mëshirën e të dërguarit të Allahut edhe tek hipokritët. Kjo nga shkak se, çdo herë kur i dërguari i Allahut e ka pasur në kompetencë të zgjedh në mes të dy çështjeve, e ka zgjedhur më të lehtë, që ta vërtetoj thënien e Allahut të Lartmadhëruar:

“Ne të kemi dërguar mëshirë për të gjithë botët.”

Pas kësaj vjen mëshira e tij për umetin e tij, që të zgjerohet, saqë Zoti i Lartmadhëruar kur e ka parë dashurinë për umetin e tij, pra dashurinë e të dërguarit të Allahut dhe dëshirën e tij që ta zgjedh më të lehtë, i thotë: **“O Muhamed, nëse dëshiron, çështjen e umetit tënd do të ta lejoja në kompetencën tënde.”** A ka çështje më të mirë se kjo? Shikojeni gjenialitetin e Muhamedit a.s. A mos tha: Unë po e marr çështjen e umetit tim në kompetencën time!? Jo. Por, ashtu me mëshirën e tij, i tha Zotit të tij: “Jo, për dallim nga unë, Ti je më i mëshirshëm për umetin tim.” Kjo, për shkak se Muhamedi a.s. është vëlla i besimtarëve, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar është Zot i tyre. E, a mund të krahasohet mëshira e vëllait me mëshirën e Zotit!?

I dërguari i Allahut s.a.v.s., e ka lënë çështjen e umetit të tij në kompetencë të Zotit të Lartmadhëruar, duke pasur parasysh se i dërguari fisnik s.a.v.s. është prej ndryshuesve, që do të thotë se ndryshuesi mund të ndryshoj sepse është aksidencial (i krijuar) dhe çdo gjë e krijuar mund të ndryshoj, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar është i pandryshueshëm dhe mëshira e Zotit për umetin e të dërguarit s.a.v.s. do të jetë e përgjithmonshme.

Pasi që i dërguari s.a.v.s. e ka dhënë mendimin e tij të mençur, çka ka thënë Zoti i Lartmadhëruar:

يَوْمَ لَا يُخْزِي اللَّهُ النَّبِيَّ وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ

“Dita, në të cilën Allahu nuk e pikëllon të dërguarin dhe ata të cilët kanë besuar.” (Et-Tehrimë : 8)

Kjo e dëshmon fjalën e Allahut: përderisa ju e keni rikthyer (çështjen) tek Unë, Unë jam më i mëshirshëm se ti për ta. Unë nuk i humbi, por gjithashtu jam më i mëshirshëm për ta për shkakun tënd.

Në mes të fjalës dhe dëshmisë

Kjo është mënyra e të vepruarit të Muhamedit a.s. me hipokritët. Ka vepruar në këtë mënyrë, i ka nderuar vetëm se e kanë thënë publikisht fjalën e islamit dhe për islamin.

Këtë dukuri, Zoti i Lartmadhëruar e paraqet në 13 ajete të Kur'anit fisnik. Në secilin ajet prej këtyre ajeteve mund të vërehen cilësitë e hipokrizisë, të cilat cilësi gjenden te hipokritët deri në ditën e gjykimit.

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ

“Ka prej njerëzve të cilët thonë: Ne kemi besuar në Allahun dhe në Ditën e gjykimit, mirëpo ata nuk janë besimtarë.” (El-Bekare : 8)

Ky ajet tregon se: Ka prej njerëzve të cilët thonë: **Ne kemi besuar në Allahun dhe në Ditën e gjykimit**. Dhe nuk është për “sot”. Vështroni për precizitetin e thënies: Allahu për ta e ka ndërlidhur besimin e ri. Kjo është sikurse ky besim është besimi i *fillimit* dhe ai tjetri është besim i *fundit*. Që e ka konceptin: Keni kujdes për “besimin” në mes të dy këndeve:

- Besimi i fillimit është **“besimi në Allahun”** dhe
- besimi i përfundimit është **“besimi në Ditën e fundit (gjykimit)”**.

Vështroni me kujdes çka kanë thënë. Krahasoni atë çka kanë thënë, fjalën si fjalë e vërtetë: “Ka prej njerëzve të cilët thonë: Ne kemi besuar në Allahun dhe në Ditën e fundit.” Mirëpo për shkak të fjalës precize Zoti i Lartmadhëruar ka thënë “mirëpo ata nuk janë besimtarë”. Me qëllim që të tregoj se çështja është atribut i patjetërsueshëm dhe nuk është ngjarje e cila ndryshon.

Po ashtu, ajeti thotë:

“Dhe ka prej njerëzve të cilët thonë.” dhe
nuk thotë:

“Ka prej njerëzve të cilët dëshmojnë.”

Thënia këtu është të shprehurit:

وَلَوْ نَشَاءُ لَأَرَيْنَاكَهُمْ فَاعْرِفْتُهُمْ بِسِيمَاهُمْ ۚ وَلَتَعْرِفَنَّهُمْ فِي لَحْنِ الْقَوْلِ ۚ وَاللَّهُ يَعْلَمُ أَعْمَالَكُمْ

“Po të dëshironim, Ne do t’ua kishim shfaqur ata (hipokritët) juve dhe ju pa dyshim se do t’i njihni nga mënyra e të folurit. Allahu i di mirë të gjitha veprat e juaja.” (Muhamed : 30)

Shenjat e hipokrizisë

I dërguari i Allahut na i ka shpalosur dhe na i ka treguar shenjat sinjalizuese, ashtu që ne të krahasojmë veprimet e vepruesit dhe ta kuptojmë. Pra, i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Shenjat e hipokritit janë tri:

- kur flet, gënjen;
- kur premton, nuk e zbaton;
- kur t’i besohet diçka, tradhton.

Kështu pra, këto janë njësi matëse për çdo pjesëtar të umetit të Muhamedit s.a.v.s.

Çka do të thotë kur të **gënjen** njeriu!?

Në rend të parë duhet ta dimë temën për të cilën flet njeriu. Kemi temën e fjalës të cilën e dëgjojmë.

Para se të flasim për temën e cila del prej gjuhës, ekziston tema në mendje, pra para se të flitet. Mirëpo, tema e mendjes, a ka ndodhi e cila ekziston para mendimit?

Unë dëshiroj të them se Muhamedi është muxhtehidë.

Para se ta dëgjosh nga unë (fjalinë) “Muhamedi është muxhtehidë”, në mendjen time është sjellë diçka vërdallë me emërtimin “Muhamed” dhe diçka tjetër e cila quhet “ixhtihadë”, e pastaj e kam thënë këtë fjali. Kështu pra, para se që të ekzistoj kjo çështje, a ka pas ndonjë ngjarje me emrin Muhamed, a ka pas muxhtehidë?

Ne themi: Po.

Singeriteti është thënia e cila buron pasi që mendja e di një ndodhi e cila ka ndodhur më herët. Ky është titullimi “**singeritet**”. Pasi që singeriteti është pas thënies së fjalës e cila buron pas të depërtuarit në mendje, atëherë nuk ka realitet për të dhe kjo është “gënjeshtër”.

Gënjeshtër ndërlidhet me hipokrizinë sepse nuk është dëshmuar se “Nuk ka Zot pos Allahut”, edhe pse me gjuhën e tij ka thënë se “Nuk ka Zot pos Allahut”, mirëpo nuk ka ngjarje ku mbështetet kjo thënie, atëherë kjo është gënjeshtër dhe kjo është shenja. Kështu pra, gënjeshtari është hipokrit.

Përpos kësaj, hipokriti kur premton nuk e zbaton. Çfarë kuptimi ka fjala **“premtim”**?

Nëse e përdor fjalën premtim **“veade”** ka kuptimin për mirë, përderisa nëse e përdor fjalën **fjala “evade”** e ka kuptimin për keq.

Me një fjalë: ka premtuar për mirë, që do të thotë: ka folur fjalë të mirë dhe pastaj e ka kundërshtuar çka ka thënë. Kundërshtimi është dy llojesh:

Njëra prej tyre që njeriu të kundërshtoj pa kurrfarë qëllimi. Ky lloj arsyetohet moralisht nëse thuhet: Premtoj inshaAllahu (Nëse dëshiron Allahu).

Po ashtu cilësia e hipokriti **“Nëse i besohet, tradhton.”**

“I besohet” ka kuptimin e amanetit. Emanet është të vendosësh një gjësend në dorë të tjetrit. Nuk ka kurrfarë lidhje tjetër me të pos lënies në dispozicion diçka. Që do të thotë, nuk ka asnjë lidhje dhe asnjë anim ose ndonjë çështje tjetër dhe bëhet përbetimi, kur premtohet.

Fjala **“emanet”** e ka kuptimin e asaj se: ai i cili e pranon, pajtohet që ta kthejë në momentin kur të kërkohet prej tij.

Kur të kërkohet amaneti dhe nuk e kthen, atëherë ndeshen dy çështje, njëra çështje ndeshet me tjetrën. Më bëhet se i dërguari i Allahut dëshiron të na tregoj neve se: Pasi që Allahu mua m’i ka zbuluar hipokritët, edhe ju mos hezitoni që t’i identifikoni hipokritët. Shenjat e hipokritit janë këto dhe këto.

Nëse krijon bindje se një njeri gënjen kur flet, nuk e zbaton atë që e premton dhe tradhton nëse i besohet, dije se ai është prej hipokritëve.

Kapitulli i tretë:

MASHTRUESIT

Kush janë mashtruesit?

Ne sqaruam se hipokrizia është dukuri dobësie sepse ka dallim nëse bëhet hipokrizi në çështje e cila nuk ndërlidhet me fenë.

Të supozojmë se umeti nuk janë fetarë dhe është përplot hipokritë të cilët janë hipokritë në çështje shtetërore ose në çështje tjera dhe themi: Ato i arsyetojmë sepse tregojnë hipokrizi ndaj atyre të cilët janë të ngjashëm me to.

Mirëpo, të bëhet hipokrizi ndaj atij i cili është më i fortë. Të bëjë hipokrizi ndaj atij i cili e mposht hipokrizinë e atij. Ai hipokrizon atë, i cili ia kthen hipokrizinë dhe nuk i bën kurrfarë dobie.

يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ

“Ata mundohen ta mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, përkundrazi, ata janë duke mashtruar vetëm veten e tyre, por nuk e ndjejnë.” (El-Bekare : 9)

Koncepti i mashtrimit

Çka nënkupton fjala “**mashtrim**”?

Mashtrim është të fshehurit e diçkaje. Nga kjo përdoret fjala “**mevduë**” që do të thotë *vendi ku shkohet për të fjetur*.

Të fshihet diçka nga dikush i cili është i një rangu me ty, lejohet, mirëpo të fshehësh prej Atij të cilit nuk mund t’i fshehësh, atëherë me këtë ti e ke mashtruar vetëm veten sepse ti vetëm se ke rënë në vendin e atij i cili të ka zbuluar ty. Nëse ti dëshiron të fshehësh diçka dhe Allahu dëshiron të fsheh diçka, ta dish se Allahu ka mundësi të fsheh, a fshehja jote mbetet vetëm mendim se gjoja ke fshehur diçka.

Zoti i Lartmadhëruar nuk ka thënë “**i mashtrojnë ata të cilët kanë besuar**”. Nuk e ka përsëritur foljen, ashtu që ndokush të mendoj se janë dy forma të mashtrimit, ashtu që njëra prej formave të mashtrimit të jetë: “Mashtrimi i njeriut ndaj njeriut.”

Ne themi: Jo, nuk i ndajmë besimtarët nga Zoti i besimtarëve sepse besimtarët i përmbahen programit të Atij të cilit i kanë besuar, që do të thotë se nuk janë të shkëputur nga Allahu.

Kështu pra, mos thuaj: Unë i mashtroj besimtarët dhe e mashtroj Allahun, por thuaj: Unë i mashtroj besimtarët dhe Allahun së bashku, sepse ai i cili flet për Allahun, ai është brenda fjalës së Allahut, brenda ligjit të Allahut. A nuk ka thënë Zoti i Lartmadhëruar:

“Ata të cilët ta japin besën ty, vërtetë ia kanë dhënë besën Allahut.”

“Dora e Allahut është mbi dorën e tyre.”

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “E mashtrojnë Allahun dhe ata të cilët kanë besuar”, duke mos e përsëritur foljen, ashtu që askush të mos mendon se mund të jetë fitimtar në mashtrim. Ata nuk kanë korrur sukses dhe mashtrimi kthehet kundër tyre:

يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ ﴿٩﴾

“E mashtrojnë Allahun dhe ata të cilët kanë besuar, ata nuk kanë mashtruar askënd përpos veten e tyre, por nuk e vërejnë dhe nuk e shohin.” (El-Bekare : 9)

Çka nënkupton fjala “**nuk e ndjejnë**”?

Pse njëherë është përdorë fjala **“nuk logjikojnë”** dhe njëherë tjetër është përdorë fjala **“nuk dinë”**.

- **“ndjenjë”** – mjet prej mjeteve për të perceptuar;
- **“dituri”** – mjet prej mjeteve për të perceptuar;
- **“logjikë”** – mjet prej mjeteve për të perceptuar.

“Ndjenjë” – të perceptosh me njërën prej shqisave. Ato shqisa:

- ose janë shqisa për dituri, të cilat shqisa rezultojnë si rezultat i çështjeve logjike,

- ose janë shqisa të cilat nuk rezultojnë prej ndonjë rezultimi, që do të thotë, çështje të cilat nuk kanë qenë, mirëpo logjika i rezulton si të qena. Të sqarojmë më konkretisht.

Themi: Çdo njeri ndjen dhe percepton, mirëpo çdo njëri prej neve nuk mund të dijë, sepse dituria tregon çështje të cilat nuk i di (percepton) ti, por i di (percepton) tjetri.

Shkalla më e lartë është: ai i cili **“logjikon”**, dhe në nivel më të ulët janë ata të cilët dinë se çka vepron tjetri.

Për këtë arsye i kemi fjalët:

- **logjikojnë,**
- **dinë** dhe
- **ndjejnë.**

Secila prej këtyre fjalëve e ka veçorinë e saj.

Ai i cili dëshiron të hiperbolizoj diçka në atë se **“nuk dinë asgjë”**, thotë: **nuk ndjen**, që do të thotë se edhe shqisat e tij (trupi i tij) nuk ndjejnë asgjë.

Pas kësaj: **“nuk logjikojnë”**, që nënkupton se mund të mësoj (të di) atë çka e logjikon tjetri, që do të thotë se mund të dijë dhe të ndjenë.

Përderisa, kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Nuk ndjejnë”**. Nuk ndjejnë asgjë në mënyrë absolute.

Përderisa kur thotë: **“Nuk dinë”**, ky është mesazhi, sepse është e mundur se nuk mund të logjikon (percepton), mirëpo ky e di logjikën (aftësinë mendore, mendimin) e tjetrit.

Nuk ka qetësi për ta, para shpirtit të tyre mashtrues

Zoti i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun me pjesë (organe) të ndryshme:

- Posedon veshët për dëgjim.
- Posedon syrin për shikim.
- Posedon gjuhën për të folur.
- Posedon mendjen për të logjikuar.
- Posedon zemrën për të besuar.

Njeriu i drejtë, i cili duhet të jetë siç e ka krijuar Zoti, duhet të jetë në harmoni të plotë me këto pjesë të trupit (organe trupore).

Besimtari, e ka krijuar këtë harmoni sepse beson me zemrën e tij, atë çka e beson e deklaron me gjuhën e tij dhe asnjëherë nuk konfrontohet me pjesët e trupit të tij.

Pabesimtari, nuk ka harmoni me pjesët e trupit të tij sepse ai nuk beson dhe e shpreh me gojë se nuk beson. Kështu, ai ka qetësi me veten e tij, mirëpo ai e ka humbur qetësinë me diçka tjetër. E ka humbur qetësinë me shoqërinë me të cilën bashkëjeton dhe me Zotin e tij, i Cili e ka krijuar që nga fillimi dhe në fund kthimin e ka te Ai.

Pabesimtari edhe pse ka arritur harmonizim me veten e tij, ai atë harmonizim e ka të përkohshëm. Shpejt do ta humb qetësinë në mes tij dhe pjesëve të trupit të tij, gjuhës së tij dhe fjalës së tij dhe në mes të zemrës së tij dhe besimit të tij. Kjo qetësi është e përkohshme, mirëpo do të përfundoj në një kohë tjetër. Do ta shoh se nuk ka qetësi madje as në mes tij dhe trupit të tij sepse në botën tjetër do të dëshmon (trupit) kundër tij. Kjo, duke u bazuar në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَقَالُوا لَجُلُودِهِمْ لِمَ شَهِدْتُمْ عَلَيْنَا ط قَالَوا أَنْطَقَنَا اللَّهُ الَّذِي أَنْطَقَ كُلَّ شَيْءٍ وَهُوَ خَلَقَكُمْ أَوَّلَ مَرَّةٍ
وَالْيَهُ ثُرَجَعُونَ

“Dhe u thonë lëkurave të tyre, pse po dëshmoni kundër nesh? Do të thonë: Allahu na ka bërë të flasim, ashtu siç e ka bërë të flasë çdo gjë. Ai ju ka krijuar për herën e parë dhe tek Ai do të ktheheni.” (Fussilet : 21)

Edhe lëkurat e tyre dëshmojnë kundër tyre. Kështu pra, qetësinë, të cilën kishin menduar se e kishin arritur me veten e tyre, nuk është qetësi tjetër pos

një qetësi e brishtë, saqë kundër tyre dëshmojnë duart e tyre dhe këmbët e tyre.

Pabesimtari edhe pse arrin qetësi për një kohë të shkurtër, një ditë do ta humb edhe këtë qetësi. Do të konfrontohen me të kur të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart, këmbët, lëkurat, atëherë çka ju ka mbetur atyre?!

Besimtari ka krijuar raporte të qetësisë me të gjithë pjesët e tij. Qetësi me veten e tij. Nuk ka kundërthënie në mes asaj çka sheh dhe asaj për të cilën ka bindje. Besimtari ka krijuar raporte qetësie në mes tij dhe shpirtit të tij. Nuk ka kundërthënie në mes të asaj çka thotë dhe asaj çka beson. Nuk ka kundërshtim mes tij dhe Zotit të tij. Nuk ka kurrfarë kundërshtimi. Po ashtu nuk ka kundërshtim në mes jetës së tij në këtë botë me jetën e tij në botën tjetër.

Sa i përket hipokritit, ai lëkundet dhe është i pavendosur. Tek ai, pjesët trupore të tij janë në dilemë dhe janë të tronditura. E, me gjuhën e tij e thotë atë të cilën nuk e ka në zemër:

Zemra e tij i thotë: **“Mos shkakto trazira”**, ndërsa,

ai thotë: **“Unë rregulloj”**.

وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ آمَنُوا قَالُوا آمَنَّا وَإِذَا خَلَوْا إِلَىٰ شَيَاطِينِهِمْ قَالُوا إِنَّا مَعَكُمْ إِنَّمَا نَحْنُ مُسْتَهْزِئُونَ

“Kur takohen me besimtarët, ata thonë: “Besojmë.” Por kur janë vetëm me djajtë e tyre thonë: Në të vërtet, ne jemi me ju, ne vetëm po talleshim.” (El-Bekare : 14)

Çka është ky kundërshtim në shpirtin njerëzor?! Për Zotin, si mund të jenë të qetë?! Për këtë arsye, në të gjitha ajetet në të cilat paraqiten këta, shohim kundërthënie, dilema dhe lëkundje:

فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ فَزَادَهُمُ اللَّهُ مَرَضًا

“Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe Allahu ua shton atë sëmundje.” (El-Bekare : 10)

Pra, jetojnë me sëmundje, nuk kanë shpresë për shërim, e sëmundja dhe tronditjet shpirtërore vetëm se u shtohet:

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ قَالُوا إِنَّمَا نَحْنُ مُصْلِحُونَ

“Dhe nëse u thuhet atyre: Mos shkatërroni në tokë. Thonë: Ne vetëm jemi duke bërë rregullime.” (El-Bekare : 11)

Këtu ekziston kundërshtimi i dyfishtë, se ne kemi thënë se shkatërrimi në tokë është të kesh pikësynim që ta rregullosh, ndërsa përkundrazi e çrregullon, a më e pakta çka kërkohet prej tyre, është që ta lënë të rregulluarën të rregulluar dhe të mos ndërhyhet në të. Ndërsa, nëse dëshiron të avancosh ambiciet, atëherë shtoja të rregulluarës rregullimin.

Zoti i Lartmadhëruar i ka rregulluar të gjitha çështjet e jetës së vërtetë. Nëse dëshiron ta zhvillosh jetën dhe ta përmirësosh jetën më shumë, Allahu të ndihmon ta realizosh edhe atë.

“Dhe Ne i kemi dhënë për çdo çështje shkaqe dhe ai i pasoi shkaqet.”

Pse?

Ai i cili i pranon begatitë të cilat i dhurohen, e bën zakon të jetë përtac, e Zoti i Lartmadhëruar ia shton, ashtu që njeriu e shton energjinë e angazhimit dhe angazhimin e punës. Dhe shumë çështje i ka lënë të lira, në mënyrë që nëse dëshiron zhvillohesh dhe vepron me elementet e domosdoshme të jetës:

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ

“Dhe kur u thuhet mos bëni çrregullime në tokë...” (El-Bekare : 11)

Ah, mjerë për ta! Thonë: Nuk bëjmë çrregullime. Por ata e kanë bërë shprehi të thonë se nuk bëjmë çrregullime, por e vërteta është se gënjejnë kur thonë: Në të vërtetë ne jemi duke rregulluar, ndërsa përkundrazi ata çrregullojnë.

Hipokritët dhe mendjelehtët

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ آمِنُوا كَمَا آمَنَ النَّاسُ قَالُوا أَنُؤْمِنُ كَمَا آمَنَ السُّفَهَاءُ ۗ أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ السُّفَهَاءُ وَلَكِن لَّا يَعْلَمُونَ

“Kur atyre u thuhet: Besoni ashtu siç kanë besuar njerëzit tjerë. Ata thonë: Po si të besojmë edhe ne siç besojnë mendjelehtët?! Por jo, në të vërtetë ata janë mendjelehtët, por ata nuk e dinë.” (El-Bekare : 13)

Mendjelehtë, ahmak. Kjo nënkupton, shqisa për t’i kuptuar çështjet. Por çka është mendjelehtësia? A është ai i cili beson në Zotin e tij, apo është ai i cili nuk beson në Zotin e tij?! Nëse ju mendoni se ata janë mendjelehtë, atëherë pra, pse ia atribuoni vetes besimin, e kështu të bëheni mendjelehtë? Edhe kjo gjithashtu është mendjelehtësi. Sa i përket hipokritëve, ata janë në dy tabore. Jetojnë në taborin e pasuesve të tyre dhe jetojnë në taborin e besimtarëve. Tash shikoje precizitetin e Kur’anit se si i paraqet ata:

“Dhe kur të shkojnë te djajtë e tyre.”

Djalli është çështje e fshehtë dhe ka nevojë për vetmim dhe përderisa fjala ka të bëjë vetëm për vetmimin, këtu kemi publikimin që duhet fshehur. Për këtë arsye, shohim se ai i cili nuk është i devotshëm, mundohet që ta fsheh aktivitetin e tij brenda fushës së rrugës së drejtë. Tentativa e tij është që të fshihet pas dëshmisë së tij se aty ka padrejtësi dhe të këqija, ashtu siç ai nuk duhet të dijë apo të shoh askënd sepse në të ka fëlliqësi. Morali është moral dhe po që se është te i devijuar.

T’i kthehemi ajetit:

وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ آمَنُوا قَالُوا آمَنَّا وَإِذَا خَلَوْا إِلَىٰ شَيَاطِينِهِمْ قَالُوا إِنَّا مَعَكُمْ إِنَّمَا نَحْنُ مُسْتَهْزِئُونَ

“E kur i takojnë ata që besuan thonë: “Ne besojmë!” por kur veçohen me djajtë e vet u thonë: Ne jemi me ju, ne vetëm jemi tallur”. (El-Bekare : 14)

Është dashtë të jetë plotësuese: “Dhe kur vetmohen te djajtë dhe duke qenë te ta thonë.” Apo të besojmë... mirëpo a nuk kanë thënë: “**Ne kemi besuar**” dhe e kundërta e kësaj do të ishte: “**Nuk kemi besuar**”.

Besimi nuk është statik, ai do të humb. Në fazën kohore të dy deklarimeve ekziston pabesimi. Mirëpo kur të vetmohen me djajtë e tyre ata janë në natyrshmërinë e tyre. Thonë: Ne jemi me ju. Fjala “**Ne jemi me ju**” nuk i largon prej tyre, ndërsa fjala “**keni besuar**” i largon prej tyre. Ky është argument për precizitetin e Kur’anit fisnik.

Shpërblimi i hipokritëve

Allahu i nënçmon (tallet) hipokritët teksa tregon se hipokritët kanë thënë: **“Vërtet ne jemi duke u tallur me ta.”** Kjo i bie sikurse Zoti i Lartmadhëruar i thotë robit hipokrit: Përderisa ke treguar hipokrizi dhe e thua me gjuhë atë e cila nuk është në zemrën tënde, do t’i pranojmë nga ti anët e jashtme të çështjeve, do të të bashkëdyzojmë, që nënkupton, të ndërlidhim me muslimanët me ndërlidhje bashkëshortore, të bëjmë të jesh trashëgimtar dhe veprojmë me ju me ligjet tona, mirëpo e bëjmë nijet (vendosim) që ti të jesh në pjesën më të thellë të zjarrit.

Po ashtu, o ti hipokrit, e kam bërë për ju që çështja publike të jetë në kundërshtim me çështjen tënde sekrete. Gjithashtu, Ne veprojmë në atë mënyrë që publikimin tënd “Nuk ka Zot tjetër pos Allahut” e respektojmë. Pra përderisa njeriu thotë se: Nuk ka tjetër pos Allahut dhe Muhamedi është i dërguar i Allahut, mirëpo pas kësaj Ne të kthejmë te pabesimtarët.

Ti, o hipokrit, je i vetmi lajkatarë?! Jo, kurrësi jo!

Allahu është lajkatori më i mirë. Edhe Ne e kemi publikimin dhe të fshehtë. Ne madje nuk të barazojmë as me pabesimtarin sepse pabesimi yt është edhe më i keq sepse ti ke përfituar me proklamimin tënd të besimit dhe Ne patjetër se do të ta kompensojmë me pabesim. Kështu, Zoti i Lartmadhëruar kur të thotë: **“Vërtet Ne jemi duke u tallur.”**, po ashtu thotë: **“Ne tallemi me hipokritin.”** Tallja, nënkupton nënçmimin. Shembull: Kur e përqesh tjetrin:

“Mjerë për secilin ofendues dhe përqeshës.” (Humeze)

“Humeze” do të thotë të përqeshësh tjetrin, qoftë edhe me shenja. Sikur kur të kalon para jush një i çalë dhe ti bëhesh si i çalë. Kështu pra, **el-humeze** dhe **lumeze** është ai i cili tallet me tjetrin duke e nënçmuar, që do të thotë ta nënçmoj njeriun.

Pasi kuptimi është që ky njeri ta nënçmoj tjetrin, duhet që ti të kesh diçka që e do dhe ti e nënçmon. Kështu, në këtë rast nënçmimi është shenjë e cila nuk ka të bëjë me besimin e shpirtit të krijesës i cili beson Zotin një.

Një send i prodhuar ka lidhje me prodhuesin e atij sendi sepse nëse ti ia gjen një të metë karriges, nuk ke të drejtë të thuash se kjo karrige ka të metë, por ti e nënvlerëson prodhuesin e asaj karrige. Kështu pra, që në momentin

kur tallesh me njeriun, e njeriu nuk ka të bëjë me krijimin e vetes së tij, atëherë ti je duke u tallur me atë të cilin e ka krijuar Allahu dhe nuk e vlerëson atë çka të ka dhuruar Allahu ty në krahasim me atë me të cilin tallesh, duke i pasur veçoritë tjera. Për këtë arsye:

عَسَىٰ أَنْ يَكُونُوا خَيْرًا مِّنْهُمْ

“Ndoshta mund të jetë më i mirë se ata.” (El-Huxhuratë : 11)

Qëllimi (i ajetit): Mund të jetë më i mirë se ata në veçori tjera apo në karakteristika tjera. Nëse unë jam më i mirë se ti për diçka, tjetri është më i mirë se unë në diçka tjetër.

Tallja

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“E mashtrojnë Allahun dhe ata të cilët besojnë.”**

Duhet që të mos e ndajmë veprimin ndaj besimtarëve, pra Zotit të besimtarëve. Kur tallet me besimtarin për besimin e tij, nuk e ndajmë talljen me Zotin në të njëjtën kohë. Kjo nënkupton se: Ata tallen me besimtarët, mirëpo përgjigja vjen nga Allahu, Ai tallet me ta.

Do të duhej të thuhet: **Besimtarët tallen me ta**, mirëpo kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Allahu tallet me ta”**, i bie sikurse Zoti i Lartmadhëruar të thotë:

يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ

“Mundohen ta mashtrojnë Allahun dhe ata të cilët kanë besuar, mirëpo ata e mashtrojnë vetëm veten e tyre, mirëpo nuk e ndjejnë.” (El-Bekare : 9)

Kështu pra, një pako, nga shkakun se besimtari e lidhë veten e tij me Zotin. Për këtë arsye, është e logjikshme që Zoti i Lartmadhëruar të thotë: **“Allahu tallet me ta.”** Çështja nuk ka të bëjë me një ngjarje tjetër ose me një njeri tjetër ose me një forcë tjetër të kufizuar, por këtu kemi të bëjmë me forcën e kufizuar përballë Forcës Absolute. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

اللَّهُ يَسْتَهْزِئُ بِهِمْ وَيَمُدُّهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ

“Allahu do të tallet me ta dhe do t’i lërë një kohë të gjatë të bredhin verbërisht.” (El-Bekare : 15)

“El-Mud” do të thotë të zgjatet diçka nga vetvetja ose nga jashtë, shembull:

Një çështje (pjesë buke) duke e përtypur ajo zgjatet prej vetes së saj, përderisa,

nëse e lidh litarin me një litar tjetër kjo do të thotë zgjatim prej tjetrit. Këtu qëndron dallimi në mes të vetzgjatimit dhe zgjatimit.

وَيَمُدُّهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ

“Do t’i lërë një kohë të gjatë të bredhin verbërisht.” (El-Bekare : 15)

“umhun” dhe “umjun”

Fjala **“umhun”** dhe fjala **“umjun”**. Dallimi në mes tyre qëndron në shkronjën e fundit. Këtë dallim e pason dallimi në substancë:

“umjun” – është verbërimi i shikimit.

“umhu” – është verbërim i vizionit.

Verbërohen – do të thotë se e kanë humbur vizionin.

“umhun” d.t.th. verbërim, pa marrë parasysh ai verbërim a është verbërim konkret apo verbërim abstrakt, vizion për programin e jetës apo të moralit, pra për verbërimin shpirtëror, që do të thotë që të jetë vizion, sepse ajo nuk verbërohet, por verbërohen zemrat.

Shikimi konkret, mund të zëvendësohet me shikimin e tjetrit, mirëpo kjo nuk ka efekt te shikimi shpirtëror dhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar **“Jeamehunë”** – janë të pavendosur dhe të pavëmendshëm. Thuaj për të çka të duash prej çështjeve kundërthënëse për aktivitetin e jetës.

Kontrata (tregtia)

Në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

أُولَئِكَ الَّذِينَ اشْتَرُوا الضَّلَالَةَ بِالْهُدَىٰ

“Ata janë të cilët kanë kontraktuar (tregtuar) humbjen me udhëzimin.” (El-Bekare : 16)

Kur të dëgjosh fjalën **“ka tregtuar”**, e nënkupton kontratën e cila shërbehet me monedhë (të holla), mirëpo, në të kaluarën ka ekzistuar këmbimi i mallrave, pra këmbim mall me mall. Para se të zbulohen letrat me vlerë është bërë këmbimi mall me mall, mirëpo më vonë letrat me vlerë janë bërë përcaktues i çmimit, që do të thotë, të hollat.

Procesi i **“blerjes”** tregon njëkohësisht procesin e **“shitjes”**:

“E kanë blerë humbjen me udhëzimin.”

E kemi paguar “udhëzimin” në këmbim të “humbjes”.

Parafjala **“bi”** tregon çështjen e dorëzuar – udhëzimin, që nënkupton, kur të blesh diçka, i dorëzon të hollat. Pra, e “dorëzuar” janë të hollat. Në këtë rast “humbja” është malli (artikulli). Kushtëzohet që ti t’i kesh të hollat për të paguar mallin. Mirëpo parashtrohet pyetja: A ka qenë me ta “udhëzimi”?

(Përgjigjja) Patjetër se kjo tregon se te ta ka qenë udhëzimi, ata e kanë poseduar “udhëzimin”, këshillat, librat e shpallura, ndërsa ata e kanë dorëzuar “udhëzimin” dhe e kanë pranuar “humbjen”:

فَمَا رَبَحَتُ تِجَارَتُهُمْ

“Nuk ju ka sjellë profit tregtia e tyre.”

Shikojeni se çfarë preciziteti ngërthen në vete ajeti fisnik, saqë koncepti i tregtisë është shitja dhe blerja.

Blerësi është konsumator, ndërsa shitësi ndonjëherë mund të jetë prodhues dhe ndonjëherë ndërmjetësues ndërmjet prodhuesit dhe konsumatorit.

Ndërmjetësuesi në këtë proces është tregtari dhe ky proces quhet tregti. Kështu pra, tregtia është mes i prodhuesit dhe konsumatorit, mirëpo ai për të realizuar këtë është i varur që të ndërlihet me ndërmjetësuesin prodhues

dhe pas kësaj fillon që artikulli të kalon deri te konsumatori. Cila është detyra jote në këtë proces?

Nëse fiton, thuhet, ka përfituar nga tregtia, që do të thotë, nuk ka dështuar. Kështu pra, kushtoi vëmendje çka vjen pas kësaj:

وَمَا كَانُوا مُهْتَدِينَ

“Dhe nuk janë të udhëzuar.” (El-Bekare : 16)

Kjo nënkupton se nuk ju ka mbetur asgjë përderisa e kanë blerë humbjen me udhëzimin. Ata, jo vetëm që kanë humbur, por kanë mbetur edhe pa bazë.

Befasia

Po të mos kishte qenë i varur prej ndërmjetësuesit, tregtari vet do të kishte pasur shpresë të përfitoj. Çka ka pritur prej asaj tregtie?.

Këtu Zoti i Lartmadhëruar ia këputë edhe shpresën e fundit të cilën e ka pasur. Dhe thotë, do t'i shtohet befasia **“Dhe nuk sjelli përftim tregtia e tyre.”**.

Kur’ani fisnik na e sjell një çështje interesante. Ndonjëherë njeriu mendon se ka dështuar vetëm me atë kontratë. Mirëpo, vjen çështja tjetër dhe Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe nuk janë të udhëzuar.”**. Këtu vjen befasia pas befasisë. Nëse ti dëshiron ta dënosh një njeri, kur ai kërkon ndihmë dhe ai kërkon ujë, ti ia sjell një gotë ujë që ai të fitoj një lloj shprese që të pi ujë pas etjes së madhe. Kur të afrohet te uji, ti e derdh ujin në tokë, kjo është befasi pas befasie.

Edhe pse thuhet se pjesa e ajetit **“Allahu tallet me ta”** ka të bëjë për në Botën tjetër, ashtu që Allahu do t’ua hapë dyert e xhenetit dhe ata mendojnë se Allahu do t’i nderoj dhe do t’i nxjerr nga xhehenemi dhe do t’i shpie në xhenet dhe kur të afrohen para derës së xhenetit, para fytyrës së tyre do të mbyllen dyert e xhenetit. Ky është lloj i talljes, dhe kjo është befasi pas befasie.

Kur’ani e tregon edhe formën tjetër në Botën tjetër, ku thotë:

وَإِنْ يَسْتَغِيثُوا يُغَاثُوا بِمَاءٍ كَالْمُهْلِ يَشْوِي الْوُجُوهَ

“Dhe kur të kërkojnë ndihmë me ujë, u jepet ujë valë, i cili i djeg buzët.” (El-Kehf : 29)

Mirëpo, parashtrohet çështja: Me ujë!? Ujë i cili nuk shuan etjen.

Në këtë kemi befasi pas befasie, që do të thotë se fillon një proces i lirimit dhe i lehtësimit dhe pas kësaj vjen procesi i shtrëngimit. Për këtë arsye, prej metodave politike të nënçmimit është që personi të ngrihet lart dhe të zbritet poshtë.

A ka hipokriti njerëzi apo ndërgjegje?

Procesi i hipokrizisë të cilën e ka shpjeguar Zoti i Lartmadhëruar është proces i cili ka nevojë për analizë shpirtërore (psikike), në mënyrë që të shihet a ka njerëzi dhe a ka ndërgjegje ai hipokrit?!

Ai i cili lajkaton dhe mashtron, ai e tregon dobësinë e tij. I forti nuk mashtron sepse ai ngjarjes i paraqitet me forcë.

Hipokriti nuk ka forcë për ballafaqim. Ai paraqitet dhe i përcjellë ngjarjet. Kush vepron kështu, ai është humbësi i parë. Ai e ka mendimin në veten e tij dhe e dëshiron mendimin e tjerëve në të dhe që nga momenti kur njeriu e dëshiron mendimin e tjerëve në veten e tij, para mendimit të vet në veten e tij, kjo është pika e parë e nënçmimit të njeriut para vetes së tij. Pse?

(Përgjigjja) Sepse ti mund ta fshehësh të metën tënde para njerëzve, por nuk mund ta fshehësh para vetes. Përderisa e sheh të metën tënde në veten tënde dhe pajtohesh me të dhe dëshiron që askush të mos e sheh atë të metë, kjo do të thotë se të tjerët për ty janë më të nderuar se sa vetja jote. Nga shkaku se ti e dëshiron mendimin e tyre, edhe pse e ke mendimin në veten tënde dhe ke pasur dëshirë që të thonë se ti je i drejtë, ndërsa ti e di se je gënjeshtar sepse ti nuk brengosesh për mendimin tënd në veten tënde, që do të thotë, vetja jote nuk brengoset për mendimin tënd në veten tënde sepse ti dëshiron ta avancosh personalitetin tënd para njerëzve. Kësisoj ti je i poshtër. Poeti thotë:

*Mjafton që njeriu të ketë turp kur e sheh të metën në veten e tij
edhe po të ishte i fshehur nga xhinët dhe njerëzit.*

Me një fjalë, e rëndësishme është mendimi në veten tënde dhe jo mendimi i tjerëve për ty. Si është e mundur, ti e di se je gënjeshtar dhe je i lumtur se je gënjeshtar, ndërsa kur ta kuptojnë njerëzit (se je gënjeshtar) pikëllohesh!?

Kështu pra, vetja e juaj është e poshtër dhe kur njeriu vetmohet dhe i paraqitet jeta e tij dhe shikon veprimet e tij dhe e sheh se nuk je në kundërshtim me çështjet tjera, nderohen dhe respektohen para jush, përderisa kush e sheh se para njerëzve ka mundur të paraqitet ndryshe dhe deri më tani ende nuk kemi folur për paraqitjen e tij me Allahun, përderisa Ai e di se çka ka në mes tij dhe vetes së tij. Kështu pra, në bazë të

përcaktimit tënd, njerëzit janë më të mirë se ti, që do të thotë se ti ke vlerë më të vogël dhe respekt më të vogël.

Kapitulli i katërt:

MËKATARËT

Dalja nga sfera e obligimeve

Zoti i Lartmadhëruar e ka urdhëruar pabesimtarin që t'i besoj. Pabesimtari nuk e dëgjon Atë, por ai i dëgjon epsheet e tij. Përderisa vepron për epsheet e tij, ai edhe shpërblimin e merr prej epsheve të tij. Në Ditën e Kijametit pabesimtari do të befasohet me ekzistencën e Zotit:

وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَعْمَالُهُمْ كَسَرَابٍ بِقِيعَةٍ يَحْسَبُهُ الظَّمْآنُ مَاءً حَتَّى إِذَا جَاءَهُ لَمْ يَجِدْهُ شَيْئًا وَوَجَدَ
اللَّهُ عِنْدَهُ فَوْقَاهُ حِسَابَهُ ۖ وَاللَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ

“Ata të cilët nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë, të cilin i etshmi e kujton për ujë, por kur arrin tek ai vend nuk gjen asgjë. Aty do të hasë në dënimin e Allahut, i Cili e paguan llogarinë e tij të plotë. Allahu është i shpejtë në llogari.” (En-Nurë : 39)

Ah, sikur pabesimtari të mos e gjente vetëm ujin. Por e gjen Allahun te vetja e tij dhe befasohet me ekzistencën e Tij, e këtë nuk e ka pasur fare në mendje. Dhe kjo i bie sikurse t'i thotë Zoti i Lartmadhëruar: Çka dëshiron nga Unë, kurse Unë nuk kam qenë në mendjen tënde. Nga bota ke marrë çka ke dëshiruar. Nuk i kemi shkëputur të mirat që i ke arritur nga puna jote:

“Dhe e gjetën Allahun te vetja e tyre dhe i priste llogaria.”

Ndoshta njeriu mund të thotë: Cili është shpërblimi i atij i cili e ka zbuluar mikrobin dhe i ka zbuluar shkaqet për shërim dhe për zbulimet tjera të cilat i zbulojnë pabesimtarët?.

Ne u përgjigjemi atyre: Njeriu e merr pagën (shpërblimin) prej atij për të cilin ka punuar. Në mendjet e tyre a ka qenë Zoti apo njeriu, bota!?. Në mendjet e tyre a ka qenë Zoti apo fama, reputacioni!?.

Ti i ke marrë të gjitha ato merita. Për ju janë shkruar libra, keni marrë medalje, e çmime e dekorime. Mos thuaj: “Zoti i ka humbur.” E vërteta është se, ka humbur ai i cili ka mëkatuar.

Devijimi i mëkatarëve

Fjala **mëkat** e ka gjenezën prej *hurms së thatë*.

Hurma kalon nëpër shumë faza të tharjes deri sa të del thelbi prej (para) lëvores dhe ne themi: Është shkëputur lëvozhga prej farës, që do të thotë se ka dalë nga lëvozhga. Këto terminologji i kanë përdorë arabët dhe me fjalën “**mëkatarë**” e kanë quajtur atë i cili ka dalë prej sferës së detyrave (obligimeve) ashtu siç del fara nga lëvozhga. Kjo është në rend të parë, pra mëkati, ndërsa në rend të dytë, e humb Allahu.

Kështu pra, duhet ta kuptojmë se Zoti i Lartmadhëruar kur e ka krijuar njeriun e ka krijuar:

- me pa të drejtë zgjedhjeje në disa çështje;
- me të drejtë zgjedhjeje në disa çështje, pra me obligime.

Obligimet gjithmonë janë: **veproje këtë**, dhe e kundërta e saj është, **mos e vepro**.

Për Zotin! Nëse i them shërbëtorit tënd, veproje këtë! A është e logjikshme që ai të nënkuptoj se ai ka mundësi që të mos e veproj? Kështu është kur ai ka mundësi të mos e vepron atë që e vepron përpos asaj çka kam kërkuar prej tij që ta vepron.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë për këtë çështje, **veproje**, dhe çështjen tjetër, **mos e vepro**. Kur Ai urdhëron, krijesat e Tij duhet të jenë të përgatitura për t’u përgjigjur. Kështu pra, Ai është në gjendje të vepron ose të mos vepron. Kandari i programit është që t’i jepet përparësi njëres ndaj tjetres, ashtu që të jetë i nënshtruar ndaj urdhrit të Allahut.

Për këtë arsye, ai i cili harmonizohet me përgjegjësitë (obligimet) dhe beson në Allahun dhe i pranon detyrat nga Allahu, atëherë Allahu ia jep kuptimin atij programi. Përdërisa, për atë i cili e kundërshton Allahun, Allahu për të parasheh errësirën.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَسْتَحْيِي أَنْ يَضْرِبَ مَثَلًا مَّا بَعُوضَةً فَمَا فَوْقَهَا ج فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ
مِنْ رَبِّهِمْ ط وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَيَقُولُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مَثَلًا م يُضِلُّ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ
كَثِيرًا ع وَمَا يُضِلُّ بِهِ إِلَّا الْفَاسِقِينَ

“Allahu nuk ngurron të sjell shembullin e mushkonjës ose diçka më të madhe se ajo. Ata të cilët besojnë, e dinë se kjo është e vërtetë prej Zotit të tyre, ndërsa, ata të cilët nuk besojnë, thonë: Çfarë kërkon të tregoj Allahu me këtë shembull? Njëpërmjet tij shumë kënd e lë në humbje, e shumëkujt ia ndriçon rrugën e drejtë. Ai i lë në humbje vetëm mëkatarët.” (El-Bekare : 26)

Besimtarët pranojnë çdo gjë brenda kornizës së besimit në Allahun, ashtu që situata e besimtarit për veten e tij është: Çka kam kuptuar kam kuptuar, ndërsa çka nuk kam kuptuar, urtësinë e saj ndoshta do ta kuptoj më vonë. Ndoshta ekziston urtësi që unë të mos kuptoj, ashtu që të vërtetohet se unë kam besuar edhe në të padukshmen, dhe që në momentin kur paraqitet e padukshme, unë besoj në të.

Ata janë prishësit e marrëveshjeve

Mëkatarët janë ata të cilët e prishin besatimin me Allahun. Kjo është çështja e parë e mëkatimit:

وَمَا يُضِلُّ بِهِ إِلَّا الْفَاسِقِينَ

“Dhe nuk humb, përpos mëkatarët.” (El-Bekare : 26)

Sa i përket **“besatimit”**, është marrëveshje e shkurtë e cila duhet të zbatohet. Kur është bërë ai besatim?

Pasi Zoti i Lartmadhëruar e ka krijuar “mendjen” me të cilën dallohen çështjet e jetës tënde, si p.sh., çka të bën dëm dhe çka të bën dobi, do të duhej që ajo mendje të arrinte në nivelin më të lartë për të përfituar begati. Paramendo, sikurse ti të ishe në shkretëtirë dhe e ke rregulluar tendën dhe flenë i vetëm në të, pastaj befasohesh kur e sheh një sofër të mbushur me të gjitha të mirat dhe me artikuj ushqimor. Për Zotin, para se të ushqehesh a nuk mendon njëherë se nga të kanë ardhur ato ushqime?!

Kështu është. Ti je në këtë gjithësi dhe befasohesh se je i shërbyer me këto begati. Këto begati nuk i ke bërë ti. Dhe askush para juve, i ngjashëm me ju, nuk ka thënë se ai vet i ka bërë këto begati. A nuk do të duhej të parashtrohet pyetja: Nga kanë ardhur këto begati?

Kështu pra, besatimi i parë është: besatimi i natyrshmërisë për t'i menduar begatitë. Kur ti nuk mendon për të dobishmen, kjo është sikurse, ti këtë besatim natyror dhe logjik e ke prishur. Ti nuk e ke prishur për çështjet e jetës tënde sepse ti i ke shikuar çështjet të cilat të bëjnë dobi. Por, përderisa nuk e mendon çështjen e cila të bën dobi, atëherë këtu ndryshon situata, për këtë arsye Zoti e falë të çmendurin.

Çka vjen prej Allahut, besimtari e pranon me veten e tij.

Çka vjen prej Allahut, pabesimtari e pranon me veten e tij.

Secili e pranon çka vjen prej Allahut, varësisht prej fuqisë së besimit apo fuqisë së pabesimit.

Ai i cili beson në Zotin, e rendit dhe e rregullon çdo gjë çka i vjen prej Zotit të Lartmadhëruar si rezultat i besimit në Allahun. Përderisa ka besuar në Allahun Zot, Krijues, të Fuqishëm, të Urtë dhe është i kënaqur me Të, dhe ka bindje të thellë në Të. Tema për një çështje buron prej Tij dhe konsiderohet kthim në bazën e çështjes së besimit.

Përderisa ke besuar se Zoti është i fuqishëm dhe se Ai është i Urtë dhe se ai është i Ditur, dhe ne kur të pranojmë diçka nga Allahu patjetër se duhet ta pranojmë mbi bazën e besimit në të cilën kemi besuar. Nëse largohesh nga diçka, për të cilën je njoftuar prej Allahut se duhet larguar, e analizon edhe një herë, ta dish se je kthyer në çështjen e besimit. Për këtë arsye, kur Zoti i Lartmadhëruar i obligon robërit e tij nuk thotë: “O ju njerëz, ju obligoj për këtë”, por i ka obliguar ata të cilët kanë besuar, siç thotë **“O ju të cilët keni besuar, u është bërë obligim juve...”**

Kjo do të thotë: O ti i cili ke besuar në Zotin dhe ke besim në mua se jam Zot dhe i Fuqishëm, i Urtë dhe i Dijshëm, beson në krijimtarinë e Tij dhe se Ai ka krijuar, Unë të obligoj për këtë dhe për këtë. Nuk është mirë që ta polemizosh atë detyrë përsëri sepse nëse e polemizon obligimin, atëherë je kthyer në bazën e çështjes së parë të besimit. Baza e çdo çështjeje obligative pranohet nga Zoti dhe besimi në Zot. Besimi në diçka nënkupton vërtetimin se çdo gjë çka vjen te ti vjen prej rrugës së Allahut.

Të sjellim një shembull: Kur pejgamberi s.a.v.s. shkoi në Isra dhe populli dëshiroi që ta luhatnin besimin e Ebu Bekri Sidikit, kur i thanë, shoku yt pretendon se ka shkuar në Mesxhidi Aksa. Ata mendonin se Ebu Bekri do të heqë dorë nga ky lajm.

Çka u tha Ebu Bekri?

Tha: Nëse veç e ka thënë, atëherë e ka thënë të vërtetën. Po ashtu ka thënë: Unë besoj në atë çka i zbret prej qielli, e si mos t'i besoj se ka shkuar në Mesxhidi Aksa?!

Na ka dhënë një çështje të sinqertë.

Kështu pra, logjikën time e kam përdorur për kategorinë e parë, e ajo është se: Unë kam besuar në Zotin dhe kam besuar në të dërguarin e Tij, e pas kësaj, kam besuar që të më transmeton çka të dëshiron.

Një ngjarje tjetër. Pejgamberi s.a.v.s. i kishte marrë borxh një personi. Pas kësaj pejgamberi s.a.v.s. atë borxh ia kthen borxhdhënësit, mirëpo askush nuk ishte prezent. Pas një kohe, borxhdhënësi shkon te pejgamberi s.a.v.s. dhe ia kërkon borxhin duke menduar se ka harruar pejgamberi s.a.v.s. se ia ka larë borxhin.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: Borxhin e kam larë te ti.

Borxhdhënësi i thotë: Nuk e ke larë.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: E kam larë borxhin te ti.

Aty pranë ishte Huzejme r.a. dhe i thotë: “Po, ta ka kthyer borxhin.” Edhe pse nuk kishte qenë prezent në momentin e kthimit të borxhit.

Pas kësaj, shkon peygamberi s.a.v.s. te Huzejme dhe i thotë: Kur e kam kthyer borxhin asnjëri nuk ishte në atë moment.

Huzejme i thotë: O i dërguar i Allahut, unë të besoj me të gjitha ato që ke ardhur, e a të mos besoj për kthimin e disa dërhëmëve borxh!?

Shikojeni pra fikhun e besimit dhe fikhun e ixhtihadit.

Pas kësaj, shikojeni të kaluarën (të parët tanë) dhe lidhjen e tyre me Kur'anin. Na është transmetuar se duke u tubuar Kur'ani nga sahabët dhe nga fletushkat tjera, ai i cili e ka marrë përsipër këtë përgjegjësi nuk e ka shkruar asnjë ajet përderisa nuk e ka parë të shkruar dhe për të cilën kanë dëshmuar dy dëshmitarë. Gjatë këtij procesi hasën në një ajet të shkruar dhe për të dëshmon vetëm një dëshmitar, e ai dëshmitar ishte Huzejme. Pra, u pranua dëshmia e vetme e tij, pa pasur dëshmitarë tjetër, nga shkak se peygamberi s.a.v.s. për të ka thënë: **“Për kë dëshmon Huzejme, mjafton vetëm dëshmia e tij.”** Kështu ne e shohim çështjen ashtu siç e parashtruam edhe më parë. Kështu besimtari i pranon gjërat.

Për këtë arsye, unë gjithmonë them për atë i cili mundohet që nga çdo çështje të adhurimit ta gjen urtësinë e saj: Mundohu ta glesh urtësinë sa të dëshirosh, mirëpo, mos pretendo se ajo është urtësia e atij adhurimi. Urtësia e Allahut është përsosmëria. Urtësia e Allahut është përsosmëria absolute dhe nuk bie në kundërshtim urtësia e çështjes me atë adhurim, ndërsa urtësia të cilën e gjen ti, mund të jetë në kundërshtim me atë çështje të adhurimit.

Urtësia është prezent në çdo obligim të cilin e obligon Allahu. Kur Zoti i Lartmadhëruar të urdhëron për një çështje, nuk duhet të pyesësh për urtësinë e saj, sepse kjo nuk është çështje e juaja. Urtësia e obligimit a duhet të jetë te i urdhëruari apo te Urdhëruesi?! A mos e di fëmija urtësinë e dhimbjes së gjilpërës kur i japim injeksion?! Mirëpo, ai i cili e di çështjen e saj dhe urtësinë e saj, është ai i cili e ka urdhëruar dhe e ka paraparë atë. Kur mendja e atij fëmije e arrin pjekurinë, ndoshta do ta kupton. Shembull: Kur të sëmuret njeriu, atëherë fillon të mendoj dhe ta pyes veten:

Çka më ndodhi?

Ndoshta kam ngrënë diçka dhe jam sëmurë?

Nëse i dhemb stomaku shkon dhe e pyet mjekun specialist të stomakut (lukthit).

Kjo është detyra e trurit (mendjes).

Kur specialisti e përfundon ekzaminimin, e gjen llojin e sëmundjes dhe e merr lapsin për të përshkruar ilaçet, unë nuk ia marr lapsin, ose nuk i them mos e shkruaj ilaçin apo mos e shkruaj diagnozën. Mendja ime ndalet aty sepse aty është mjeku specialist.

Pastaj, pasi që unë kam shkuar te specialisti, unë vetëm e dëgjoj atë.

Kur të vjen vizitori që të më vizitoj për shkak të sëmundjes dhe të më pyes: Pse po e përdor këtë ilaç, a duhet të hyj me të në laborator kimik. Jo. Ti përgjigjesh: Kështu ka thënë mjeku specialist.

Kështu, ti agjëron sepse Zoti ka thënë “Falu dhe agjëro.” Për shkak se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë falu, duhet të kesh kujdes të mos e bësh të varur ligjin me arsyeshmërinë (urtësinë) e tij. Kush agjëron, agjërimi e shëron agjëruetin, e atëherë agjërimi nuk është adhurim. Shembulli i tij është sikurse zjarrrutisti i cili agjëron për t’u shëruar. Te besimtari, bazike është që të pranoj urdhrat e Allahut pa e ditur urtësinë e urdhrit. Ky është besimi.

Dialogu në mes të zjarrputistit dhe muslimanit

Disa njerëz, të cilët nuk i takojnë fesë islame, polemizojnë shumë me besimtarët për çështjet e fesë së tyre.

Në Bagdad, një zjarrputist i thotë muslimanit: Ju pretendoni se kur të shkoni në xhenet, “sa herë që të ushqeheni, ushqimi nuk pakësohet,” përderisa, çdo gjë që merret, e kundërta pakësohet. Kjo është e pakuptimtë sepse pakësohet!?

Muslimani i thotë: Çka mendon, nëse ti e ndez qiriun (zjarrin) tënd, pastaj vijnë të gjithë banorët e Bagdadit dhe i ndezin qirinjtë e tyre nga qiriut yt, a mos pakësohet drita e qiriut tënd?

Zjarrputisti heshti pak, pastaj i thotë: Ju pretendoni se në xhenet do të ushqeheni dhe nuk do të keni jashtëqitje?! Në këtë rast zjarrputisti dëshiron t’i krahason çështjet e kësaj bote me çështjet e botës tjetër.

Muslimani i thotë: Çka ka interesante (të habitshme) këtu? Embrioni zhvillohet në barkun e nënës së tij. Për t’u zhvilluar ka nevojë për ushqim. Njeriu zhvillohet përderisa ushqimi i cili hyn në barkun e tij është më i madh se sa del prej tij. Po të kishte fëmija jashtëqitje në barkun e nënës së tij, do të ishte bërë i fëlliqur gjatë zhvillimit në rrugën e tij.

Besimtari e pranon fjalën prej Allahut dhe e pranon nga transmetuesi i cili i përcjell fjalët e Allahut, se ajo është e vërtetë, zemrën veç e ka të qetësuar dhe nuk shkon më tutje që ta qetësoj sepse veçse e di se është fjalë e Allahut, por këtë e dëshiron ai i cili e ka të lëkundur besimin e tij. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّهِمْ

“Sa i përket atyre të cilët kanë besuar, ata e dinë se ajo është e vërteta prej Zotit të tyre.” (El-Bekare : 26)

Kjo është e vërtetuar në mënyrë globale dhe të përgjithshme, se përndryshe... Nëse kërkoj përgjigje për çdo çështje, kjo do të thotë se unë nuk besoj në Atë, por unë besoj në *çështjen* dhe për çdo çështje kërkoj arsyetim.

Fjala **“Zot”** nënkupton: Atë që e merr përgjegjësinë për t’u përkujdesur për ty. Ai është Zotëria yt. Shikojeni prindin me fëmijët e tij edhe pse ai nuk

i ka krijuar. Edhe pse ai është vetëm shkak për ekzistencën e tyre, ai prapëseprapë qëndron në edukimin dhe përkujdesjen e tyre.

Nëna e mban barrën e vështirësive nga dashuria. Baba qëndron i uritur për t'i ushqyer, qëndron pa rroba për t'u siguruar rroba fëmijëve. Parashtrohet pyetja, pse?

Përderisa, kur ai i cili nuk të ka krijuar, i cili është vetëm shkaktar, përkujdeset me këtë përkujdesje kaq të madhe dhe lodhet kaq shumë, si është çështja me Zotin, i Cili i ka mbjellë në zemrën e tyre atë dashuri aq të madhe, atë dhembshuri aq të madhe dhe atë butësi, varësisht prej nevojës prej atij i cili ka nevojë për përkujdesjen e tij!?

Për këtë arsye, kur është pyetur një arabe, cilin prej fëmijëve e do më së shumti? Ajo është përgjigjur:

- Të voglin deri sa të rritet;
- të sëmurin deri sa të shërohet;
- të humburin deri sa të gjendet.

Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“O biri i Ademit. Unë të dua ty. Për shkak se të dua ty, duhet të më duash Mua.”**. Që do të thotë se, Zoti i Lartmadhëruar vepron me ty me veprimin e Dashurisë dhe pas kësaj, kjo gjendje nuk ndryshon, përpos se me mëkatim ndaj tij, mirëpo, Ai e lë hapur derën e pendimit, mu sikurse prindi.

Shikojeni gjithësinë e cila është nënshtruar për njeriun sepse gjithësia në tërësi është adhuruese, lavdfalënderuese dhe e cila bën sexhde. Çdo gjë është brenda sistemit. Zbrazëtira (e meta) në gjithësi paraqitet në çështje në të cilat njeriu ka të drejt zgjedhjeje. Kurse, çështjet në të cilat njeriu nuk ka të drejtë zgjedhjeje janë të qëndrueshme. Kështu pra, në çështjet në të cilat njeriu ka të drejt zgjedhjeje njeriu e shkatërron botën.

Pse? A mos ka thënë ndonjëherë dielli se unë sot nuk do të lind për njeriun?

A mos ka thënë ndonjëherë era se unë nuk ia dërgoj ajrin njeriut?

A mos ka thënë ndonjëherë gomari se nuk jam në shërbim të njeriut dhe nuk e barti barrën.

Jo!

Kështu pra, disharmonia është në çështje për të cilat ke të drejt zgjedhjeje.

Qielli ka thënë: ***O Zot! Më lejo mua që të zbres copa nga qielli ngase ai është ushqyer me të mirat Tua dhe i pengon të mirat Tua dhe nuk falënderon.***

Toka ka thënë: ***O Zot, më lejo ta përpij njeriun sepse është ushqyer me të mirat tua dhe i pengon të mirat tua dhe nuk falënderon.***

Çka u ka thënë Zoti?

Zoti ka thënë: ***Po t'i kishit krijuar do t'i kishit mëshiruar. Më lini mua me robërit e mi. Nëse pendohen, unë i dua ata, por nëse nuk pendohen, do të sillem mirë me ta.***

Kjo është përgjigja fisnike nga Zoti i Lartmadhëruar.

Kështu pra, besimtari, që në momentin kur e pranon Allahun, e di se çdo gjë çka i vjen nga Allahu i Vërtetë është e vërtetë. Ajo çka është e kërkuar nga njeriu është që të pranoj se është e vërtetë, përderisa sa i përket mënyrës se si është e vërtetë, nuk është e domosdoshme që ta di ai. Pse? Sepse po të dish çdo gjë me urtësi, nuk do të kishte pasur kuptim besimi. Sepse në rend të parë është definuar besimi në të padukshmen sepse ti nuk e beson të padukshmen, përveç se duke u mbështetur në bindjen tënde se e ka thënë i Vërteti, Zoti i Lartmadhëruar. Kështu pra,

Pranimi i parë:

فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّهِمْ

“Sa i përket atyre të cilët kanë besuar, ata e dinë se është e vërtetë prej Zotit të tyre.” (El-Bekare : 26)

Pranimi i dytë:

وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَيَقُولُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مَثَلًا

“Ndërsa ata të cilët nuk besojnë, thonë: Çka ka dashur Allahu me këtë shembull?” (El-Bekare : 26)

Ne gjithmonë duhet ta bëjmë dallimin në mes të “Fail-it” (vepruesit) dhe “Kabil-it” (pranuesit).

“Vepruesi” është një, përderisa

“pranuesi” janë të shumtë.

Shembull:

Në dimër, ti del nga shtëpia, është ftohtë dhe ti i fryn dhe i fërkon duart për t'i nxehur. Kur të pish qaj të nxehtë i fryn për ta ftohur çajin pak.

Në rastin e parë fryn për nxehje.

Në rastin e dytë fryn për ftohje.

E vërejmë se vepruesi është i njëjtë a shkakton diçka të kundërt në një rast tjetër.

Përderisa, pranuesi është i ndryshëm dhe i shumënumërt.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمِنْهُمْ مَّنْ يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ حَتَّىٰ إِذَا خَرَجُوا مِنْ عِنْدِكَ قَالُوا لِلَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ مَاذَا قَالَ أَنِفًا ؕ
أُولَٰئِكَ الَّذِينَ طَبَعَ اللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ

“Dhe ka prej tyre të dëgjojnë ty, kur dalin nga vendi ku je ti, i pyesin ata të cilëve u është dhënë dituria: Çfarë tha ai më parë?! Këta janë ata, zemrat e të cilëve ua ka vulosur Allahu dhe të cilët pasonin epsheet e veta.” (Muhamed : 16)

Në suretu Fusilet Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَلَوْ جَعَلْنَاهُ قُرْآنًا عَجَمِيًّا لَقَالُوا لَوْلَا فُصِّلَتْ آيَاتُهُ ۖ أَأَعْجَمِيٌّ وَعَرَبِيٌّ ؕ قُلْ هُوَ لِلَّذِينَ آمَنُوا هُدًى وَشِفَاءٌ ۖ وَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ فِي آذَانِهِمْ وَقْرٌ وَهُوَ عَلَيْهِمْ عَمًى ؕ أُولَٰئِكَ يُنَادَوْنَ مِنْ مَّكَانٍ بَعِيدٍ

“Sikur ta kishim shpallur Kur’anin me një gjuhë tjetër, ata do të thoshin: Ah sikur ajetet e tij të ishin të qartësuar. Vallë, pse të jetë në gjuhë të huaj, ndërkohë që është në gjuhën arabe. Thuaj: Ai (Kur’ani) është udhëzim dhe shërim për besimtarët. Por ata që nuk besojnë janë të shurdhër dhe të verbër, njësoj si të thirreshin prej vendeve të largëta.” (Fusilet : 44)

Kur’ani është i njëjtë, por pranuesit janë të ndryshëm.

Kështu është çështja në pranimin e të gjitha çështjeve të padukshme dhe pranimi të të gjitha çështjeve për të cilat duhet marrë qëndrim logjika (mendja) e besimtarit. Pra, i pranon si të vërteta, i kuptoi apo nuk i kuptoi ato.

Për këtë arsye, ne kemi thënë se ky është shkaku i ekzistimit të ajeteve të paqarta (muteshabih) në Kur’anin fisnik. Parashtrohet pyetja: Pse kanë ardhur ajetet e paqarta (muteshabih) në Kur’anin fisnik?

Kur'ani ka zbritur për të na i sqaruar neve ligjet. Përderisa ajetet e paqarta (muteshabih) kanë zbritur për të na dhënë peshoren e besimit. Kur ka thënë:

وَأَخْرَجْنَا مَثَابِهَاتُ

“Në të keni ajete të paqarta (muteshabih).” (Ali Imranë : 7)

Çështja e cila është e varur me ligjin është se nga ti kërkohet ta pranosh që të jetë plotësisht e qartë. Sa i përket çështjes e cila është e ndërlikuar (e varur) me çështjet kozmike, bota bashkëkohore është e kufizuar, pastaj për t'i sqaruar ato më pastaj, vijnë gjeneratat e ardhshme, të cilave do t'ua mundësoj Allahu për t'i sqaruar.

Prej tyre ka:

ajete të qarta, ata janë thelbi i librit dhe,

tjerat janë të paqarta. Ata, zemrat e të cilëve janë të prira nga e pavërteta, ndjekin ajetet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por kuptimin e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë të thelluar në dituri thonë:

أَمَّا بِهِ كُلُّ مَنْ عِنْدَ رَبِّنَا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ

“Ne i besojmë, të gjitha ajetet janë prej Allahut. Të gjitha janë prej Zotit tonë. Këtë e kuptojnë vetëm të logjikshmit.” (Ali Imranë : 7)

Të thelluarit në dituri thonë: Ne besojmë në Zotin edhe pse nuk kemi kuptuar asgjë. Të gjitha janë prej Allahut. Të qarta prej Zotit dhe të paqarta janë prej Zotit. Shkak i kësaj është se mendja është mjet i të kuptuarit (perceptuarit), po ashtu edhe syri dhe hunda:

A mundet që syri t'i përfshijë të gjitha gjërat apo është e kufizuar në shikimin e çështjeve!?

Edhe veshi është i kufizuar në të dëgjuar, saqë nëse zëri largohet prej tij, nuk mund të arrij deri te zgavra e veshit dhe nuk dëgjon.

Ngjashëm është edhe me mendjen.

Për këtë arsye, peygamberi s.a.v.s. ka thënë: Çka të mësoni prej ajeteve të qarta, veproni me to dhe çka të kuptoni prej ajeteve të paqarta besoni. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِنْ رَبِّهِمْ ۚ وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَيَقُولُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ
 بِهَذَا مَثَلًا ۚ يُضِلُّ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ كَثِيرًا ۚ وَمَا يُضِلُّ بِهِ إِلَّا الْفَاسِقِينَ

“Sa i përket atyre të cilët kanë besuar, ata e dinë se është e vërtetë prej Zotit të tyre. Sa i përket atyre të cilët nuk kanë besuar, thonë: Çka ka dashur Zoti të thotë me këtë shembull?” (El-Bekare : 26)

Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë sprovë për besimtarin. Sprova duhet të kuptohet si një çështje testimi. Nëse të jepet një pjesë e arit dhe dëshiron që ta dish a është fals apo origjinal, e hedh në zjarr që të shihet se cilës i takon. Zoti dëshiron të dallon të mirën nga e keqja. Ai e di se cili është i mirë dhe cili është i keq, por ai dëshiron që nëpërmjet këtij koncepti (kësaj diturie) ta kuptosh ti sepse po të thoshte në bazë të diturisë tënde, ndoshta thua, sikur të kisha analizuar do të kisha shpëtuar.

Zoti i Lartmadhëruar nuk është i varur nga idhujtaria e idhujtarëve. Por që ta dimë se e vërteta është e të gjithëve, por Atë nuk e konsiderojnë Zot që të gjithë. Por është Zot për ata të cilët i besojnë Atij. E Ai është Zot Përkujdesës për të gjithë. Pse disa nuk e kanë adhuruar Zotin, a mos do të thotë se është ndërprerë relacioni i përkujdesjes së Zotit në kozmos?

Jo! I ka thënë diellit rrezato, dhe i ka thënë tokës përgjigju nevojave. Kjo është begatia e Zotit Përkujdesës.

Ai i cili beson në Zotin e vërtetë, i përfiton edhe begatitë e Zotit, edhe begatitë e Zotit Përkujdesës, ndërsa,

ai i cili nuk beson në Zotin, përfiton vetëm begatitë e Zotit Përkujdesës.

Në fund... Pabesimtari, te Zoti i Lartmadhëruar është asgjë sepse ai vepron vetëm me shkaqet dhe të shkaktuarat.

Falënderimi i takon Zotit fillim dhe mbarim!

Përmbajtja:

DYSHUESIT	3
<i>Fjalë në të cilën nuk ka dyshim.....</i>	<i>5</i>
<i>Perceptimi dhe besimi obligativ</i>	<i>7</i>
<i>Kulminacioni i besimit në besimin e të padukshmes</i>	<i>8</i>
<i>Domosdoshmëria e besimit për të besuar atë çka ka zbritur prej Zotit</i>	<i>10</i>
<i>Mënyra e besimit në Ditën e fundit (ditën e gjykimit).....</i>	<i>11</i>
<i>Llojet e besimit</i>	<i>12</i>
<i>Kur tërhiqet vërejtja patjetër se duhet përqendrim</i>	<i>14</i>
<i>Domosdoshmëria e të përmbajturit e rrugës së drejtë</i>	<i>17</i>
HIPOKRITËT	21
<i>Zemra e shëndoshë</i>	<i>23</i>
<i>Fuqia e hipokrizisë.....</i>	<i>24</i>
<i>Fushëbeteja e besimit</i>	<i>26</i>
<i>Qeverisësit e tokës</i>	<i>27</i>
<i>Hipokrizia është dukuri shpirtërore</i>	<i>29</i>
<i>Gjeneruesit e hipokritëve</i>	<i>30</i>
<i>Koka (kryesori) e hipokrizisë dhe toleranca e të dërguarit të Allahut</i>	<i>32</i>
<i>Hipokritët dhe feja islame</i>	<i>34</i>
<i>Në mes të fjalës dhe dëshmisë</i>	<i>36</i>
<i>Shenjat e hipokrizisë.....</i>	<i>38</i>
MASHTRUESIT	41
<i>Kush janë mashtruesit?.....</i>	<i>43</i>
<i>Koncepti i mashtrimit</i>	<i>44</i>
<i>Nuk ka qetësi për ta, para shpirtit të tyre mashtrues</i>	<i>46</i>
<i>Hipokritët dhe mendjelehtët</i>	<i>49</i>
<i>Shpërblimi i hipokritëve.....</i>	<i>51</i>
<i>Tallja.....</i>	<i>53</i>
<i>“umhun” dhe “umjun”</i>	<i>54</i>
<i>Kontrata (tregtia)</i>	<i>55</i>
<i>Befasia.....</i>	<i>57</i>
<i>A ka hipokriti njerëzi apo ndërgjegje?.....</i>	<i>58</i>
MËKATARËT	61
<i>Dalja nga sfera e obligimeve.....</i>	<i>62</i>
<i>Devijimi i mëkatarëve.....</i>	<i>63</i>
<i>Ata janë prishësit e marrëveshjeve</i>	<i>65</i>
<i>Dialogu në mes të zjarrputistit dhe muslimanit</i>	<i>69</i>